

BIBLIOTEKA
SHTETIT


398.8
Z 45

ZEMRAT
ME DIELL
MBUSHUR

*Këngë
popullore*

398.8
Z 45

ZEMRAT
ME DIELL
MBUSHUR



*Këngë popullore
nga rrëthi
i Fierit*

34323

SHTEPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

Materiali i këtij vëllimi është nxjerrë nga arkivi i bërthamës shkencore të folklorit të rrethit të Fierit.

U përgatit për botim nga:

FREDERIK JORGAQI
NIKOLLA MARGILAJ

Redaktor

AGRON FICO

I

DO KËNDOJ S'DO PUSHOJ FARE

Do këndojoj, s'do pushoj fare,
për Partinë famëmadhe,
që na ngriti mal mbi male,
me të larta ideale.
O Parti, ojeta jonë,
gati jemi përgjithmonë.

Corrush

YLL PËR POPULLIN E PARTINË

Gjirokastra në një brinjë
ka lindur trimin e mirë,
Enver Hoxhën, bukurinë,
ndoqi e ndjek drejtësinë
për puntor' e fshatarsinë.
Të na rroj Enveri ynë,
yll për popull e Partinë!

Ninësh

KJO HOXHÁRA JONE

Kjo Hoxhara jönë
s'është si më parë,
tokat móçalishë
ne i bëmë arë.
Anekënd tyre
mbjellim çdo lloj farë
misër edhe grurë,
pambuk të bardhë.
Rroft' e qoftë Partia
që e lulëzoi,
dhuratë rinisë
ajo ia dorëzoi.

Hoxharë

MES PËR MES LUGINËS

Mes për mes lugineš. Gjanica kalon,
tubave të mëdha nafta po vërvhon.
Në lugine të thellë heshtje më nuk ka,
bilbila të tjerë ia thonë la më la.
Në Ballsh pran' maleve po ngrihen kolona,
çdo gjë e bëjmë yet', ne me forcat tona.

Zharrëz

MOJ SHQIPNI, KALA E FORTË

Kangën tonë, kangën e gëzimit,
ia kushtojmë ditës çlirimit.¹⁾
Qeshu, gëzohu, moj Shqipni!
Lum e lum, kush pô të pri.
Prin Partia kapedane
në bllokada, në tufane.
Moj Shqipni, kala e forte,
nuk i tutesh kurkujt në botë.
Kazmë, pushkë fort shtrëngojmë,
socializmin vet' ndërtojmë.

Pojan

1) 35-vjetorit të Çlirimtit

KUDO SI FANAR NA NDRITE

E madhe kjo vepra jonë,
mëi mëna Parti...!)

Që ditën që u krijove
plane të shumta hartove,
popullin e organizove,
drejt fitorevë na çove
gjersa lirinë na dhurove.
Sa bllokada shkatërrove,
armiqve planet u dogje.

Petovë

1) Përsëritet pas çdo vargu

LUMJA¹⁾ TI, MOJ GRECALLI

Lumja ti, moj Grecalli,
ç'e ke këtë nur e zjarr në gji,
ç'ia hape zemrën trimit të rrallë,
Enverit që mposht 'tufan'.
Mirë se erdhe, shoku Enver,
në Myzeqenë tonë të bardhë,
fjala jote është 'fanar'
Myzeqenë ta bëjmë hambar.

Grecalli

1) Kjo këngë i kushtohet vizitës që bëri shoku Enver Hoxha në Grecalli në qershor 1968.

HJDHE VALLEN, MYZEQARKE

Hidhe vallen, myzeqarkë,
tunde fort shaminë,
kënga sot jehon fuqishëm
për Partinë.
Ti, moj myzeqarkë,
dikur ishe e mjerë
sot në sytë e tu
kudo sheh pranverë.
Çdo ditë të gëzuar
punojmë në arë,
që t'i marrim tokës
grur' e ar të bardhë.

Grecalli

PUNOJMË TË LUMTUR PËR JETËN E RE

Fshati i Myzeqesë
sot po lulëzon,
djem e vajza bashkë
fushës po punojnë.
Po punojnë të lumtur
për jetën e re,
të gjithë të gëzuar
me këngë e hare.
Me shkolla, me drita
fshati si qytet,
të bashkuar, shokë,
do punojmë për jetë.

Roskovec

O NË FIERIN TONË, LULËZON JETA E RE

O në Fierin tonë, lulëzon jeta e re,
eja, ti, moj shqetë, të punosh me ne...¹⁾
Erdhi hekurudha këtu në Myzeqe,
fërshëllim' e trenit një gëzim për ne.
Azotiku, Teci, një vepër e re,
sot në arat tona po shpérndahet pleh.

Mbrostar

1) Përsëritet pas çdo vargu

O PARTI, O YLL I NDRITUR

O Parti, o yll i ndritur,
ti udhëheqëse je për ne.
O sa lart që na ke ngritur
me mësimet që na dhe.
Të luftojmë burokratizmin,
një sëmundje e keqe,
të luftojmë çdo gjë të huaj,
që s'ka vend këtu tek ne,
se kemi Partinë e Punës,
trime në mes dallgëve.

Seman

DENONCOHET SOT TRAKTATI

Në Tiranë flet Mehmëti,¹⁾
gojë hapur bota mbeti.
Denoncohet sot Traktati,
vleft' e tij kaq e pati,
se i doli boja fare,
ndaj ne sot e anullojmë.
Keni bërë akte barbare,
agresor' ju akuzojmë.
Zëri i fort' i Shqipërisë
dërrmon tradhtinë e Rusisë.

Fier

1) Në shtator 1968 Shqipëria denoncoi Traktatin e Varsavës.

PËR GRATË MYZEQARE

Do marr një valle,
dale mengadale,
për gratë myzeqare
siç ishin më parë.
Plot vuajtje dhe halle,
agai iu bërtiste,
nga shtëpia i nxirrte,
me kamxhik u binte.
Vrarë dhe dërrmuar,
me zemër copëtuar.
Zhdukëm skllavërinë,
sollëm lumturinë,
të lira punojmë,
të drejtat gëzojmë.

Seman

SA LEZET TË PASKA PUSHKA

Sa lezet të paska pushka,
vajzë, moj „kutjotëja“¹⁾
Dhe gjerdanin përmbi supe
me një yll të kuq në ballë
si trimëreshat me pallë,
në qitje e para dole
shokë e shoqe i nderove.

Kutë

1) Përsëritet pas çdo vargu

E PARA SULMUESE DOLE

Vjen lumi ova-ova,
moj nëno, nëne!¹⁾
Unë punova dhe s'u lodha,
e para sulmuese dola,
gjithë normat i kalova,
e para nga shoqet dola,
dhe flamurin unë e mora.

Ballsh



34323

1) Përsëritet pas çdo vargu

HIDHE VALLEN LEHTE-LEHTE

Hidhe vallen lehtë-lehtë,
fustan bardha fletë-fletë.
Hidhe vallen shtruar-o,
vashëz-o, syshkruar-o.
Hidhe vallen, tund shaminë
për Enverin, pér Partinë,
që na sollën lumturinë.

ALBANIA SHQIPÉRI TOKË FLORIRI

Çu hap lajmi kaq shpejt:
pusi i ri C dymbëdhjetë,
Shqipëri, moj paç shëndet:
Nafta brof ia bën përpjetë,
Shqipëri, ç'të ka lezet!
Çdor gjë do ta bëjmë vetë:
bukën, naftën e çelikun
vet' i kemi e s'i marrim!
Dorën kujt nuk ia zgjatim
emër nderi shqipes i japim.

Zharrëz

BILBILI KUR ZBRET NGA MYZEQEJA

Bilbil, kur më zbret nga Myzeqeja,
ngelesh i mahnitur,
thuaja, bilbil, thuaja
për jetën e ndritur.
Dielli nëpër fusha,
zemrat me diell mbushur,
thuaja, bilbil, thuaja
për jetën e bukur.
Zëri i myzeqarit
(o sa lartë është ngritur)
thuaja, bilbil, thuaja
për jetën e ndritur.

Kooperativa bujqësore
«Qemal Stafa»

VALLE E KENDUAR GRASH

Fushës Myzeqesë hajdeni, vështronani,
ngado të shikoni do bëni çudi,
s'ka më baltë e ferra, lulëzon Myzeqeja,
fshatrat socialiste ziejnë nga hareja,
nga mali te deti, fushës anembanë
zë buçet traktori, nafta nga çdo anë.
Myzeqeja nuse, nuse, moj gjithë nur
tejpërtej fushës, rendiment, flamur.

Seman

SHKOI NË PUNË VASHA

Shkoi në punë vashat
dielliisa pa dalë,
gonxhe trëndafili,
gjethet palë-palë.
O shih sa bukur
duket fshati i ri,
drita elektrike
ndriçon qdo-shtepin.
Brigada në punë
shkon si vetëtimë,
këngën më të bukur
këndon për Partinë.
O shih sa bukur
duket vash' e re,
seç i qesh fytyra
kur punon me ne.

Adbunacë

PA SHIKONI SHQIPËRINË

Pa shikoni, Shqipërinë,
o shokë Shqipërinë,
t'rroj' Enveri me Partinë,
o shokë me Partinë,
që na sollën lumturinë,
o shokë lumturinë,
lumturinë dhe begatinë,
o shokë begatinë,
e bën dritë Shqipërinë,
o shokë Shqipërinë.

Suk

TRËMJA NUSE, MALLAKASTER

Lart Partia, moj Mallakastër,
mbi çdo majë seç të ngriti
shqipe e bukur, krahëhapur
me folenë kështjellë graniti!

Sa lart, o shqipja Parti,
sa lart, o na ngrite ti,
atje ku të tha Enveri.
Në rrëthim, por në strall
vetëtim e heqim vallen,
hedhim vallen kryelartë,
nuk na tremb asnjë bllokadë.
Posi nuse, Mallakastër,
je stolisur sot ti,
rrjedh në dej gjak i pastër,
lart të ngre nëna Parti.

.....
Nget shqiponja nëpër maja,
shikon tokën që e rriti,
ngre oxhaqet kjo uzina,
dora jonë seç e ngriti.

Krahët hap e krahët mbyll
kjo shqiponja porsi era,
grurin det me krah' e përkund,
nga tarracat zbret pranvera.

Ballsh

U çdon taniçatët e partitit
dhe qëndruesit të partitit
që kanë bërë i vjetër së bashku me
partitit komunist, partitit të

~~SHUMË E ZONJA U TREGOVE~~

Që ditën që u knijove,
moj Partia jonë,
shum' e zonja u tregove,
moj shqiponja jonë!
Në çdo vend kandilat like,
moj Partia jonë,
ndeze dritën elektrike
moj shqiponja jonë!
Gjithë të mirat na i solle,
moj Partia jonë!
Nga fitorja në fitore,
moj shqiponja jonë!

Greshicë

NE QDO VEPER DJERSA JOTE

Valë-valë grykë e Gjanicës po gjëmon
nga brigadat vullmetare në aksion.
Zemra jote zjarr e flakë, moj rini,
mendja jote, duart e tua si flori!
Me guxim dritën e diellit e rrëmben,
melodia e këngës sate kudo zieh.
Në çdo vepër ëjersa jote shkon rrëke,
në kantiérë kombinatë, në trase.

Aranitas

E LEHTË SI FLUTUR

Kur më zbret nga kodra
porsi zog i bukur,
më derdhesh në fushë
e lehtë si fluturë.
Shoget e gjithë fshatit
segj na janë në garë,
bjeri, vajzë, shatit
të qoftë punë e mbarë.
Me shokë e me shoqë
normën bëjmë për ditë,
fshatit tonë të dashur
ja shtojmë stolitë.

Zharrez

U NGRITA PA ZBARDHUR DITA

U ngrita pa zbardhur dita,
mora draprin edhe ika,
në rrugë shoqet i prita.
Me to punën e fillova,
të gjitha në garë i ftova,
edhe garën e fitova,
më duarplot në festë shkova.

Grecalli

1) Përsëritet pas çdo vargu

KËNGË PËR PUSIN 542

Në Marinëz të Fierit, o një pus i ri,
lumja ti, moj Shqipëri...¹⁾)
Një flakë e kuqe, o një tym i zi,
nuk qe flakë e kuqe, po qe një flori.

Patos

1) Përsëritet pas çdo vargu
2) Këngë e ngritur për fontanën e pusit 542 në vitin 1956.

БИЛДИРЈА СА ДРАГИМ ЧЕЛЕНДИЧАМ
DRITË E PAÇ, O MOJ PARTI

O shokë, do këndo jnjë këngë,
o shokë more,¹⁾
këngën e Partisë sonë
që pruri dritat në rëfshat, që
në çdo shtëpi e në çdo prag;
që nga Jugu në Veri
dritë paç, o moj Parti.

Ngraçan

1) Përsëritet pas çdo vargu

ANI, MIRE PO KCEN, MOJ ÇIKA KOSOVARE

Ani, mirë po kcën, moj çika kosovare,
ani, merre kangën dhe kceje një valle
për Partinë e Punës, nanën tonë të madhe,
kceje një valle për bacën Enver,
jetën tonë e bani lule në pranverë.
Të jehoj' në fusha, të jehoj' në male,
ta dëgjoj' anmiku, anmiku i zi,
mish e kockë ne jemi me nanën Parti.

**Grupi kosovar i kooperativës bujqësore
Pojan**

FSHATIN DO TË LULËZOJME

Djemtë — Moj e mira boll e bukur,
a je zog a mos je flutur?

Vajzat — As jam zog, as flutur s'jam,
po bujkeshë enarin e kam.

Djemtë — Moj bujkeshë, hej, puna mbarë,
ç'ka po bam atje në arë?

Vajzat — Papërtim po punoj
fshatin tim ta lulëzoj.

Djemtë — Moj bujkeshë, moj shtatë selvie,
pushka në dorë sa të ka hije.

Vajzat — Pushkën kurrë s'e lëshoj nga dora,
bash si Shota, bash si Nora.

Djemtë — Moj bujkeshë, moj lule borë!
hej, të lumtë e bardha dorë!

Të gjithë — Bashkë punojmë, vigjëlojmë
jetën tonë ta lulëzojmë.

**Grupi kosovar i kooperativës hujqësore
Pojan**

VAJZAT TONA

Vajzat tona si sorkadhe,
si në fusha dhe në male.
Në aksionet vullnetare
punojnë e s'lodhen fare.
Nëpër çetat vullnetare
stërviten pa u lodhur fare,
atdheun së bashku mbrojmë,
edhe këngën nuk pushojnë.

Rromës

Ç'KE BILBIL QË NUK KËNDON

Te plepat e rrugës sonë,
o bilbilo,¹⁾
Ç'ke bilbil që nuk këndon?
Ja le radhën vajzës sonë,
ajo në pambuk punon,
dy norma në ditë i tejkalon.
Te plepat e rrugës sonë,
ç'ke bilbil që nuk këndon?
Ja le radhën djalit tonë,
ai në kanal punon
dy norma në ditë i tejkalon.

Seman

1) Përsëritet pas çdo vargu

SHQIPËRI ZEMËRLUANE

Shumë vjet kanë kaluar,
syrin pish' duke vrojtuar,
popull dhe ushtri në këmbë,
barutin e hamë me dhëmbë.
Shqipëri balli me ar,
lindë shqipen¹⁾ në tufan
syrin dritë, shtatin sorkadhe
lerë e rritur nëpër male.
Shqipëri zemërluane,
armiqve tmerr u kalle
si kështjellë në kohë çave
nëpër luftëra qërimtare.

Greshicë

1) Partinë Komuniste Shqiptare (sot Parti e Punës e Shqipërisë)

TË GJITHË NE JEMI USHTARË

Të gjithë ne jemi ushtarë,
kufitarë e marinarë,
artilierë dhe pilotë,
kudo vendit i dalim zot.
Në çdo kodër e në çdo breg,
në çdo shkrep e në çdo shteg,
ne mbrojmë qiellin dhe tokën,
mbrojmë punën edhe shokët.
Mbrojm' oxhakët që përpjetë
bisedojnë veç me rëtë.
Stërvitet pa pushim
gjithë populli ynë trim.

Hekal

POPULLI VETË PO I HARTON

Kushtetutën tonë të re
i gjithë populli diskutoi,
me gëzim dhe me hare,
nen për nen e miratoi.
Shqipëria socialiste
gjithmonë përparrë marshon
nenet e saj të arta
populli vetë i harton.
U verbon sytë armiqve,
zemrën miqve ua gëzon,
115 shkallë të kuqe,
kështjellë e vendit tonë.

Cakran

1) Kushtuar Kushtetutës së re të RPSSH-së të miratuar
në vitin 1976.

TE PUNOJMË BASHKË NË ARË

Mirë se erdhët, o qytetarë,
mirë se erdhët!
Të punojmë bashkë në arë,
me njëri-tjetrin në garë,
me duar plot në pesëvjeçarë.
Të vjelim pambukun, t'korrim grur të ri
o, të lulëzojë, o ky fshat i ri.

Grecalli

1) Përsëritet pas çdo vargu

SOT JE BËRË NUSE E RE

Mallakastra heroike,
sa e bukura që je,
në çdo kodër, lapidar,
kujtime nga lufta ke.
Dikur pëllëmb' e llogore,
sot je bërë nuse e re.
Çdo armiku që të shkeli
si shpërblim plumbin i dhe,
të na rrojë Parti e Punës,
timonieria është për ne.

Greshicë

VAZHDIMISHT RRISIM PRODHIMET

Cakrani rrethuar me male
plot prodhime e begati,
dikur oxhaku bejlerëve
të kish lënë pa dituri.
Me thirrjen që bëri Partia
në këmbë u çove ti,
luftuan trimat cakranjot'
që nga Jugu në Veri.
Edhe sot ne me punë
prijmë përpara si gjithnjë,
vazhdimisht rrism prodhimet
si na mëson nëna Parti.

Cakran

1) Kjo kooperativë, për rendimentet e larta, ka marrë titullin «Hero i punës socialiste»

FSHATI I MYZEQESE SOT PO LULËZON

Fshati i Myzeqesë sot po lulëzon
djem e vajza të bashkuar sot punojnë,
po punojnë të lumtur për jetën e re,
të gjithë të gëzuar me këngë e hare.
Çajnë traktorët fushat, arat gjelbërojnë,
dritat e Partisë për ne po ndriçojnë.
Me drita, me shkolla, fshati si qytet,
të bashkuar, shokë, të punojmë përjetë.

Frakull

Ç'KANË FUSHAT QË BUÇASIN

Ç'kanë fushat që buçasin,
o shoko?¹⁾
Nga traktorët që po ngasin,
sulm e gara po bërtasin.
Ç'kanë fushat që lulëzojnë?
Nga traktorët që punojnë.
Ç'kanë fushat që kuqojnë?
Nga flamurët që valojnë.

Cakran

1) Përsëritet pas çdo vargu

SI KA QENE KJO MYZEQEJA

Si ka qenë kjo Myzeqeja,
moçalishte dhe këneta.
Prindërit tanë argatë punonin,
bukën dot s'e siguronin,
dhe fëmijët të uritur,
rreckosur dhe 'rraskapitur.
Zhdukëm bej dhe agallarë
dhe ngritëm Partinë në ballë.

Seman

FUSHAT TONA SA PJELLORE

Fushat tona sa pjellore,
sa pjellore janë.
Plot me grurë dhe pambuk
mbushur anembanë,
kodrat veshur me ullinj,
gruri si flori.
Po buçasin zemrat tona,
rrofsh, o moj Parti.

Zharrez

SHQIPERI BALLI ME AR

Tridhjetë vjetë kanë kaluar
natë e ditë duke punuar,
popull dhe ushtri në këmbë
barutin e hanë me dhëmbë.
Shqipëri tridhjetëvjeçare,
syrin pishë, shtatin sorkadhe,
lërë e rritur nëpër male,
për armiqtë s'pyetke fare.

Greshicë 1974

VASIL SOTA DJAL' I RI^a

Vasil Sota djal' i ri,
lindur, rritur në Verri.
Kur shkoi në ushtri
u radhit në kufi.
Vigjilent e syapatrembur,
guximtar e shtathedhur
shkelësit plumbim i ka derdhur.
Guximtarin Vasil Sota
një plumb ç'e merr te koka,
le ta dijë gjithë bota,
se Shqipëria s'u kaloka.
Amanet ai ka lënë:
— Mos më qani, bab' e nënë,
për atdheun rash me nder,
rroft' Partia shoku Enver!

Afrim

1) Vasil Sota nga Verria e Fierit, vrarë në përleshje me shkelësit e kufirit 1974.

TETEQIND BALLË UNITETI

Një tërmet fshatrat i shembi,
zemrat tonë nuk i trembi,
si gjithmonë erdh pranë Partia,
u ngrit në kambë e gjithë Shqipnia.
Fjal' e ngrohtë e Partisë,
anembanë gjithë Shqipnisë,
posi rreze dielli ndriti
popullin në kambë e ngriti.
Ushton kanga, ushton jehona
nga Bistrica, tek Valbona.
Shpitë i ngritëm me forcat tonë,
më të bukura, më të forta.
Tetë ballë ishte tërmeti,
tetëqind ballë ish uniteti.

Grupi kosovar Dërmënës

UNITETI YNË DO TË JETË ÇELIK

Shpalosi flamurët,
Vlor' në breg të detit,
flamujt e fitores
dhe të unitetit.
Uniteti ynë
do të jetë çelik,
si grusht bashkuar
në Front Demokratik.
Me traktorin tonë,
dritën që gris natën,
me çelik të pastër
ne çajmë bllokadën.
Ballëlart, krenare,
marshon shqipja jonë,
tridhjetë e pesëvjeçare,
me Partinë shqiponjë.

Adbunac

Këngë e ngritur për Kongresin e 5-të të Frontit Demokratik të Shqipërisë, që u mbajt në Vlorë në qershor 1979.

HYSNI KAPO KOMISARI

Hysni Kapo komisari,
gojëmjalти, zemërjarri,
kréshnik e shqiponjë mali.
Si flamur prije i pari,
Hysni Kapo sekretari,
mendjemprehti, guximtari,
bir i shtrenjt' i këtij vatani,
në botë t'u dëgjua nami.
Vepra jote shumë e çmuar,
me germa të arta shkruar,
Hysni Kapo urtësia,
Besniku nga Labëria,
shok të ngushtë të kish Enveri,
në ballë të kish Partia.

Frakull

II

TUNDE TI, MOJ ÇETA PLAKË

Tunde ti, moj Çeta Plakë,
ndize zjarr e ndize flakë,
fashizmit që erdh në prag
derdhi plumbin që ka hak.
Kamionët vargan-vargan,
ku shkon ti, o breshkaman?
Në Qafë ka zënë pusi,
trimja jonë djalëri.
Janë bijtë e lirisë
fajkoj të shqipe Partisë.
Gra e burra gjithë në këmbë,
plumbat i kapin me dhëmbë.
Qafë e Sykuqit gjëmon,

era zuri e këndon.
Këndon këngë trimërie,
Mallakastër ç'të ka hije.

Ballsh

Këngë kushtuar Çetës Plakë të Mallakastrës dhe aksionit
të parë në Qafën e Sykuqit më 5 shkurt 1943.

MALLAKASTRA NUK DOREZOHET

Disa ditë para korrikut
beu¹⁾ na dërgoi një fjalë:

- Do bëhen operacione
në gjithë vendin anembanë.
Të bashkohemi me fashizmin,
të ngremë flamur të bardhë.
- Mallakastra nuk dorëzohet,
nuk e ngre flamurin e bardhë,
armikun do ta luftojmë,
t'i japim plumbin në ballë.

1) Ali bej Këlcyra — eksponent i Ballit Kombëtar. Para Operacionit fashist të Qershoret ky tradhtar i bëri thirrje popullit të Mallakastrës e Tepelenës, tek Rrapi i Dervenit, që të ngrinin flamurin e bardhë, të mos e luftonin fashizmin.

FLAMURI MË YLL PËRPJETË

Qafë e Sykuqit, moj grykë,
na kënaqe atë ditë.
I bëre fashot varricë,
i bëre se ashtu thanë.
— Greshicës do t'i vëmë zjarrë!
Oficerët italianë
me dylbi shikojnë fshanë.
— Mama mia, ç'kemi parë!
Greshica ka bërë kalanë.
Kala e Dulajt në breg
maliher e belgjik kërcet,
flamuri me yll përpjetë,
si luanë vërtiten djemtë.

Greshicë

KORRIKU MË DATËN TETË

Korriku më datën tetë,
seneja dyzet e tre,
gra, burra të Mallakastrës,
me në krye Mehmet Shehnë,
të udhëhequr nga Partia
bënë mbledhje në Poçem.
Ballë e italianë vendosën
në det që t'i hedhin.
Rrofsh, moj Mallakastra trime,
e bëre si kurdoherë,
shtove radhët partizane
besa-besën me Enver.

Greshicë

Bëhet fjalë për mbledhjen e Poçemit më 8 korrik 1943,
ku mallakastriotët dhanë besën për të luftuar fashizmin
dëri në fund.

TE UJËT Ë FTOHTE NË POÇEM

Te Ujët e Ftohtë në Poçem
mallakastriotët sa qenë
u betuan pleq e djem:
«Mallakastrën ta mbrojmë,
nga fashistët që kërkojnë
ta djegin, ta përvëlojnë».
— Rrofsh, moj Mallakastër, ti,
u dogje u bëre hi,
po luftove për liri,
fashistët ngado që erdhën
gjakun si rrëke e derdhën.

Kutë

BËRI BALLI NJË «KONGRES»¹⁾

Shëndreu nja katra-pesë...
bëri Balli një «kongres»,
bejlerët e qepazësë,
të luftojnë kundër nesh.
Kadri²⁾ beu me fuqi
të gjith' ballistët i mblođhi
gjer te ura i përçolli,
u dha armë e gjerdanë,
dhe zuri e mbajti fjalë,
u tha: «Djema, udhembarë,
të na deli faqebardhë,
Asim³⁾ benë keni të parë
ta njihni për kumandar».«
Hipi pelës e u nis,
kur kaloi përmby Gjanicë,
zuri zemra i lëvis,

1) Në dhjetor të vitit 1943 ballistët bënë një mbledhje në Fier për të shuar Luftën Nacionalçirimitare në rrethin e Fierit.

2) Kadri Cakrani – eksponent i Ballit Kombëtar
3) Asim Xhindoli – eksponent i Ballit Kombëtar

se i thonë plumbi i Partisë,
që të merr sisë më sisë.
U nis e në Fratar doli
dështoi e nukë polli.
Përhapsi në partizanë,
atje mirë gjeti belanë.
Po ç'ka parë Asimi i mjerë?
Për tri orë e bëri Fjerë,
si lepur ferrë më ferrë
e la dhe të shkretën pelë.

Kutë

UNE TE NJOH TY HISTORINË

Në çdo kodër, në çdo brinjë,
unë të njoh ty historinë,
djemtë e lindur në rrëthim.
Mehmet Shehu ngrë dylinë,
ndizet zjarr në malin Sinjë,
në Kapaj plumbat po grijnë,
bombat bien me ulërim,
plumbat bëhen trëndelinë,
ne gjithmonë me Partinë.

Damës

PËRMBI KOSHOCICË U NDEZ LUFTË E RREPTË

Viti më dyzet e katër, tетori nё mes,
pёrmbi Koshovicë¹⁾ luftë e rreptë u ndez,
Lufton Grupi i Tretë, lufton me gjermanë,
hidhen partizanët para si luanë,
tmerrohen armiqtë, si korba tё vrarë.
Atje pёrmbi Qafë, pesë trima na ranë:
Kili²⁾, Kostandini³⁾ edhe tre tё tjerë,
i kujton një popull, Partia pёrherë.

Grecalli—Fier, 1980

-
- 1) Koshovicë — qafë nё afёrsi tё Fierit
 - 2) Kili Daulle, partizan i Grupit tё Tretë tё Mallakastrës.
 - 3) Kostandin Peto, partizan i Grupit tё Tretë tё Malla-kastrës.

BARUTIN ME GRUSHT E HANË

Mallakastër bëhet lufta,
kërcet mitralozi e pushka,
partizanët tufa-tufa,
hedhur dyfekët mbi supa.
Këta trima partizanë
barutin me grusht e hanë.
Po ballistët nga vanë?
Ikën dhe morën dynjanë,
se ka trima ky vatan.

Greshicë

DHJETË SOKOLAT E MALIT

Këshilltarët e Hekalit,
dhjetë sokolat e malit,
këmbë e duar me zinxhirë
ku i çoni, more qafirë?
Ujë kërkuan, ujë s'u dhanë,
iu tha buza, more xhan.
mbahuni trima partizanë
se luftoni për vatanë.
Pyet Minushja për Islamm':
— Ku janë këta luanë?
Xha Qerimi tha një fjalë:
— Qëlloni, more tradhtarë,
Vesikua s'ka tjetër djalë,
po Taipin nuk e qan.
Ali Hoxha zë këndon
Hodo Kamberin e fton,
Isa Beqirin me grykë
ballistët po hapin sytë.

Dhe me pushkë kur u ranë:
«Rroftë Partia!», ata thanë
— O trima flini të qetë
se hakën jua marrim vetë.

Ballsh

DO MARR PENËN PËR TË SHKRUAR

Do marr penën për të shkruar,
more, një këngë të re,
për dëshmorin Ceno Metka,¹⁾
për trimin e maleve.
S'e duroi dot robërinë
fali jetën për Atdhe,
e udhëhoqi idealit
për një shoqëri të re.
Partizan i Grupit të Tretë,
në vitin dyzet e tre,
plumbi i dorës tradhtare,
të ndau në moshë të re.
Në themelë derdhe gjakun,
prandaj i pavdekur je.

Klos-Fier, 1980

1) Ceno Metka nga fshati Klos, partizan i Grupit të Tretë të Mallakastrës, vrasë më 10 shkurt të vitit 1944.

LULE FERIDE, MOJ XHAN

Në Çiplakë, mbi Vajkan,
lule Feride,¹⁾ moj xhan.²⁾
U përleshe me gjermanë,
seç të ra mortaja pranë,
të theu këmbën e krahnë.
Me Sadushin³⁾ si luan,
u hodhët mbi istikam.
Ferideja mbeti e vrarë
dhe shokët me lot e qanë.
— Shokë, mos u dëshpëroni,
luftën më ashpër vazhdoni,

1) Feride Begaj, partizane e Brigadës së 16 Sulmuese, ra te kodrat në Çiplakë, afér fshatit Vajkan, në përpjekje me forcat gjermano-balliste, në vitin 1944.

2) Përsëritet pas çdo vargu.

3) Sadush Myftari nga Skrapari, rënë te kodrat në Çiplakë, afér fshatit Vajkan, së bashku me shoqen e brigadës, Feridenë.

armikun ta shpartalloni,
vendin tonë ta çlironi,
bejlerët i shpronësoni!
Mos kujto se vetëm ti,
lule Feride, moj bijë,
janë njëzet e ca mijë,
që dhan' jetën për liri.

Vajkan— Fier, 1980

DJALEË, TRIM I MYZEQESE

Zoi Çuko¹⁾ nga Mbrostari,
djaleë trim i vegjëlisë,
ç'i rrëmben armët i pari
për lirinë e Shqipërisë.
Gjëmojnë malet tej e ndanë,
lufta seç u ndez e rreptë,
luftojnë trimat partizanë,
lule, moj Brigadë e Pestë.
Përmes flakësh prin i pari
Zoi Çuko nga Mbrostari,
mbi armikun qëllon rreptë,
djali trim i Myzeqesë,
po një plumb sa keq e mori,
e goditi brinj' më brinjë,
iu qëndis kraharoni,
e dha jetën për Partinë.

Grecalli — Fier 1980

1) Zoi Çuko nga fshati Mbrostari i rrëthit të Fierit, partizan në Brigadën e 5-të Sulmuese, rënë në përpjekje me forcat gjermane, në fshatin Kallarat të rrëthit të Vlorës më 25 shkurt të vitit 1944.

BISHTI I MALIT, O I SHKRETE

Bishti i malit, o i shkretë,
seç na hengre disa vëtë.
Fajin nuk e pati mali,
po e pati tradhtari.
Nënës vanë e i thanë:
— Ty, Hakinë,¹⁾ seç ta vranë!
— Mos ma thoni atë fjale,
Hakiun e kam të gjallë,
fali jetën për vatanë,
për flamur, për idealë,
të rroj fronti çlirimtar,
se s'e lë hakën pa marrë.

Aranitas — Fier 1980

1) Haki Sulaj, ish-kryétar i këshillit popullor të fshatit Aranitas, u-vra nga organizata tradhtare e Ballit Kombëtar.

MU NË MES TË LUSHNJËS

Mu në mes të Lushnjës, o një lapidar,
Loni Dhamo,¹⁾ trim i rrallë,²⁾
ç'thonë germat e arta në mermer të bardhë?
Të rriti Libofsha kurban për yatan,
tradhtia të zuri tek vrisje gjermanë,
torturat, që hoqe, me sy nuk janë parë:
gjilpëra ndër thonj edhe zjarr në ballë.
Ç'e thirrën xha Jorgjin,³⁾ të shihte hatanë.
— Bir, ti mbahu burrë, se babai nuk qan!
Një ditë e një natë në Lushnjë t'hoqën zvarrë!
— Ja se trego shokët, ja s'të lëmë të gjallë!
Ç'u ngrite në këmbë edhe the një fjalë:
— Komunistët vdesin, frik' vdekjen s'e kanë.

Libofshë — Fier, 1980

1) Loni Dhamo, dëshmor i Luftës Nacionaçlirimtare.
2) Fërsëritet pas çdo vargu.
3) Jorgji Dhamo, babai i dëshmorit, patriot.

VAL' E TURBULLT VJEN SHKUMBINI

Val' e turbullt vjen Shkumbini
vërtitet me shpejtësi
kalon drejt Adriatikut
shpie lajm me rëndësi
për Brigadën Dymbëdhjetë
që lufton me trimëri.
Partizanët s'duan t'ia dijnë,
s'luajnë këmbë e s'trembin sy
gati dy ditë e dy netë
vazhdojnë luftën me furi.
Komisar e komandant
Shefit¹⁾ e Braho,²⁾ të dy
në kohën kur dhanë xhan
«Rroftë Partia!» ata thanë.

Hekal

1) Shefit Hekali – komandant i batalionit të parë të Brigadës së 12 S. Vrarë në luftimet që zhvilloi brigada kundër gjermanëve në rrugën Elbasani-Rrogoszhinë.

2) Ibrahim Sako – shok lufte i Shefitit, vrarë po atë ditë.

DERVISH HEKALIT

Dit' e prillit dymbëdhjetë,
Dervish o lule,¹⁾
shkrove batalionit tretë:
— Më dërgoni njëzet vetë!
Njëzet veta ç't'i dërguan;
Kuçin për ta rrethuar,
gjermanët për t'i sulmuar.
Dhe lufta më të mbaruar
seç vjen një plumb i mallkuar
të godit në kraharuar!
Dervish, fli i qetësuar,
se tyja haku t'u muarr
për një, njëqind e paguan.

Hekal

1) Përsëritet pas çdo vargu.

2) Dervish Hekali — Hero i Popullit, zëvendës komandant i Brigadës së 5-të S. U vra trimërisht në Kuç më 12 prill 1944.

III

KËNGË PËR SKËNDERBEUN

E gjithë bota anembanë
flet për trimin tohë luan.
Shkruajnë e shkruajnë historianë
Skënderbenë të gjallë e kanë.
Pesëqind e ca vjet vanë
kujtojnë trimin kapedan.
Thërret shqipja 'nën flamur:
S'e harroj Skënderin kurë,
Skënderbeu me shqiptarë
shpëtoji Evropën mbarë.
Skënderi bashkoi vatanë,
luftoi turq e venecianë.

Reth Libofshë

KËNGË PËR BAJRAM CURRIN

Ç'kanë bjeshkët që po dridhen,
Bajram Curri i gjallë nuk lidhet,
tym e flakë n'bjeshkë të Dragobisë,
lufton trimi i vegjelisë
kundër dorës së tradhtisë,
për lirinë e Shqipërisë.
Pushka e tij fort qëllon,
derdhet gjaku në Valbonë,
pa u shemb bjeshka, kalaguri,
gjallë s'dorëzohet Bajram Curri,
nuk dorëzohet biri i Gjakovës,
heroi i Shqipes dhe i Kosovës.
Në Dragobi ku gjaku rrodhi,
një tufë lule Enveri mblodhi,
një ditë maji ty t'i solli.
Ndrit Jezerca, ndrit Shkëlzeni
me respekt të kujton Enveri.
Bajram Curr, o Bajram Curr,
emri yt s'harrohet kurrë.
ndrit në shekuj si flamur.

S'të harron kurrë malësia,
në gji të vetë të ka Shqypnia,
Hero të Popullit të bani Partia.

**Grupi kosovar i kooperativës bujqësore
Pojan**

MYZEQARET LUFTOJNÉ

U bubu, ç'është ky qamet,
lufton mbreti me një mizë,
Alush Frakulla ndë Myzeqetë
i bën llogoret me drizë.
Myzeqarët luftojnë
nëpër shi e në dëborë,
jo si agallarët tanë
në të shirë e në të korrë.

Myzeqe

Këngë për kryengritjen në Myzeqe më 1835 të drejtuar nga Alush Frakulla.

NE GRESHICË VAJTE E RE

— Mallakastre sipërme,
çdo vënë në batare
vrate goxha Isuf¹⁾ be.
— Isuf be, Isuf be,
na Berati kur dole
me top e me xhephane
në Greshicë vajte re.
Kërkove raki e meze,
dhjamë njeriu në palare,
kërkove çupa e gra të ve,
ç'të bënë muhasere,²⁾
Rrapo Hekali ku je.

Greshicë

1) Isuf është Vrioni, i ngarkuar nga Porta e Lartë.
kërkoi të zbatonte Reformat e Tanzimatit në Mallakastër

2) Muhasere — rrëthim

ISUF BEU NË KARBUNARË

Isuf beu në Karbunarë,
si kjo nusja në të parë.
Isuf be, o Isuf be,
kërkove ujë e s'pive.

— Në vafsha n'Hekal i gjallë,
për pleq e pér myftarë,
pér Bejo zinë në Drizar,
e pér Lamçë Kremenar,
pér Çelo Marko Alinë,
pér Hysen hoxhë qafirë.

— Të gjithë trimave me radhë
të keqen ke pér t'u marrë
në bigë lulet t'i varën.

Hekal

Gojëdhëna thotë se dikur Rrapo Hekali e paska izoluar
Isuf bej Vrionin në Karbunarë të Vlorës, kur kërkonte ujë
i tregonin poçen me ujë tek frëngjia e qilarit dhe nuk i jep-
nin ujë por thyenin poçet.

PRITM', O ISUF BEU, PRITM'

Në Greshicë erdhe e re¹⁾
Rrapo Hekali ku je?
Ku je, o Rrapo Hekali,
Greshicës iu vu zjarri.
— Pritm', o Isuf beu, pritmë,
në të zënça, s'ke të mirë,
gjakun ta kam për të pirë,
në dorë do ta marrë mëlçinë,
veshjen me dy fije brinjë.
Moj Greshica maj-a-maja,
vringëllon shpata, kumbaraja,
për tri ditë u bë hataja.

Hekal

1) Është fjala për vajtjen e Isuf Vrionit.

DËRGON PASHA NJË FERMAN

Dërgon pasha një ferman:

- Ju pleqësia në Drizar,
të gjallë ta kapni Lumânë,¹⁾
ta dorëzoni në hapsarë.
- Në e kapim, por dot s'e mbajmë,
se ná grim, na bën hatanë,
na bën lakra me pallë.

Drizar

1) Luman Elmazi, komandant i çetës së Drizarit gjatë kryengritjes kundër Reformave të Tanzimatit 1847.

HAJDE, MORE TRIMI LIKA

Hajde, more trimi Lika,¹⁾
trimi i madh zemrën me çika,
s'dije fare g'ishte frika,
se ishe gjatpër me pikë.
O trimi Like Drizari,
të kish shok Rrapo Hekali,
njëlloj palla edhe kali,
e tunde atje në Sinjë,
i le bejlerët pa brinjë.

Drizar

1) Like Drizari nga fshati Drizar, luftëtar i çetës së fshatit, shok i Rrapo Hekalit, pjesëmarrës në vrasjen e bejlerëve Vrionas në Sinjë të Beratit më 1847.

TOPI BAM E TI PO TUTJE

Tunde, Zenel Xhafua,¹⁾ tunde!
Topi bam e ti po tutje,
të shkojnë plumbat mi supe,
hipuro në mushkë të kuqe,
vetëtin palla me lule.
Tunde, xha Zeneli, tunde!
C'e more qishën e kuqe!²⁾

Aranitas

-
- 1) Një nga kryengritësit, shok i Rrapo Hekalit, që u shqua në luftimet e Beratit, ishte nga katundi Aranitas.
 - 2) Kisha e Beratit.

MOS MË DIL PËRPARA KALIT

Ç'janë ata që shkojnë zallit?
Trimat e Rrapo Hekalit.
— O halldup, bajgë e gomarit,
mos më dil përpara kalit,
se të pres gjysmën e ballit
me majën e jataganit.

Kutë

MOJ GRESHICA MAJA-MAJA

— Moj Greshica maja-maja,
të rrëh topi e kumbaraja!
— Moj Greshica gropë-gropë,
hëngre treqind e ca koka.
Juve gratë nga Greshica,
bëfshij djem dita për dijtë!
O moj Mallakastër e mjerë,
ç'u dogjtë nga dy për derë!¹⁾

Greshicë

1) Në Greshicë u bë një luftë e ashpër. Sipas këngës, nga kryengritësit mbetën më se 300 të vrarë.

DEL, O LUMI I VLORES

Del, o Lum i Vlorës-o,
del se do të dalim-o,
të mëdhenj, të vegjël-o.
Të pjekur në Povël-o,¹⁾
kemi hall me Vrion-o,
na kërkon xhelepet-o.
Xhelep e tymjake s'ka,
është vendi fukara.

Greshicë

1) Povël – përrua që derdhet në Vjosë.

Fshatarët mallakastriotë i bëjnë thirrje fshatarëve të Lumit të Vlorës pér të luftuar kundër bejlerëve Vrionas që donin të zbatonin Reformat e Tanzimatit.

DOLËN GRATË SI THËLLËZA

Moj Greshica rrëza-rrëza,
dolën gratë si thëllëza,
kur kalonin ndriste qielli,
floku supeve, rreze dielli.
Dolën gratë lule maji,
bashkë me Rrapo Hekalin,
kur u sulën, ndriti toka,
vetëtimë përmbi topa.
Kjo Greshica shkëmb e gurë,
dolën gratë si furtunë,
kur sulmonin, tundej dheu,
si stërgjyshi, Skënderbeu,
Rrufe gratë hidhen mbi prita.
bashkë me bijtë si petrita.

Greshicë

SOKËLLIN RRAPO HEKALI

Tundet fusha, tundet mali,
sokëllin Rrapo Hekali.
Ky Rrapua një burr' i parë,
ç'i vrou tre pashallarë,
në Sinjë ua bëri varrë,
të vijnë zonjat t'i qajnë.

Hekal

DOLI MARSI E HYRI PRILLI

Doli marsi e hyri prilli,
s'këndon qyqja, as bïlbili.
Rrapon e ngriti veziri,
e shpuri nga Manastiri,
as e vau, as e fërkoi
veç me helm e helmoi.
— Rrapo Hekali ku je?
Keq për ty e keq për ne,
na mbeti vendi raje.

Hekal

Në disa gojëdhëna thuhet se Rrapo Hekalin turqit e
helmuani në Manastir.

UNË JAM NGA SHQIPËRIA, ABDYL FRASHËRI

Abdyl, prishe pasurinë,
e bëre flori,
hipe vaporit e shkove
vajtë në Frëngji.
Brenda te Bismarku vajte
ndënje në skami,
seç të pyeti ky Bismarku:
— Djalë, nga je ti?
— Unë jam nga Shqipëria,
Abdyl Frashëri.
I arritur në ato male
me lirinë në gji.
Ju lutem, shikoni mirë,
ju për Shqipëri,
mos e ndani copa-copa
sikur s'ka njeri.
Do luftojmë gra e burra
sa të shuhemi.

Kutë

DEL ISMAILI NGA DETI

Ra një yll në mes të detit,
lajmërim i gjithë miletit:
Po del Ismaili¹⁾ nga deti.
As i vrarë, as i sëmurë,
mbushur duart me flamurë,
i thotë t'huajit «jam unë
një atdhetar nga pleqësia».
Thotë: «Të rrojë Shqipëria».

Patos-Fshat

1) Ismail Qemali
Këngë e ngritur për Shpalljen e Pavarësisë.

SHQIPËRINË Ç'E NDEROI

Vjen një djalë¹⁾ nga Libohova,
djalë, o deli djalë...²⁾
I mësuar në ato shkolla.
Hyri në vapor e doli,
në Paris vajti qëndroi,
Esat pashën ç'e kërkoi
dhe i thirri: «Pashë, pashë!
Dale, dale të piqemi bashkë,
kam një fjalë për të thënë,
kam një plaçkë për të dhënë.
Esat pashën ç'e qëndroi
që të shtatat ia numëroi
Shqipérinë ç'e nderoi.

Seman

1) Avni Rustemi, Hero i Popullit, vrau në Paris tradhatarini Esat pashë Toptani.

2) Përsëritet pas çdo vargu

LANET PAÇ, MOJ DITË E MARTE

Lanet paç, moj ditë e martë!
U mbyll tym e u mbyll flakë
nga manxerat dhe dogratë.
Pa dëgjo, moj Vlorë e shkretë,
dil shiko trimat me fletë,
Refat Dervishin¹⁾ me çetë.
Mallakastër dhe përpjetë,
burrë në shtëpi nuk mbet,
grupe-grupe, çetë-çetë
Nëna, motra duall në shkallë:
— Udhë e mbarë, vëllezërit tanë!
Prapa mos kini meraknë,
se dhe ne na keni pranë,
me nder të derdhni gjaknë,
sé lëftoni për vatanë.

Hekal

1) Refat Dervishi (Shehu) udhëheqës i fshatarëve të Hekalit në Luftën e Vlorës të vitit 1920,

QAF' E VLOREËS MAJA-MAJA

Qaf' e Vlorës maja-maja,
ç'e rreh topi nga kalaja,
ç'i vete tymi dumana,
dumana ç'i vete tymi
doli Sëlami si ylli
— O kurveleshas, ku jini?
Se këtu bën beli trimi.
Poshtë nga spitala hyri;
te spitala më të dalë
ballë për ballë me xheneral',
flakën shoshoqit ia dhanë,
një në zemër, një në ballë.
Selam Musa Salaria,
ti po të qan Shqipëria.

Aranitas

NËNTËQIND E NJËZET VITI

Nëntëqind e njëzet viti,
komandant Halim Hamiti¹⁾
Mallakastrën seç e ngriti,
edhe djemtë i radhitë,
përmbi Vlorë i vërviti.

Hekal

1) Halim Hamiti — komandant çete, pjesëmarrës në
Luftën e Vlorës,

KËNGË PËR NAUN DOKON (PRIFTI)

Myzeqeja Naun Dokon¹⁾ e rriti për Shqipëri,
me pushkë e libra në dorë luftoi e s'u tremb ai,
bashkë me shokë, me Fan Nolin, bashkë me trimin
Avni,
bënë luftë me bejlerët, luftë për demokraci.

Bashkë me Josif Stalinin, anëtarë në një parti
mësoi marksizmin, mori dituri.
Emri yt, Naun, ndrit në histori
si emrat e trimave që ranë për liri.

Libofshë

1) Naun Doko (Prifti) – demokrat revolucionar (1896-1937).

KËNGË PËR KRYENGRIJTJEN E FIERIT

Ç'e gjeti Fierin këtë radhë,
o more shokë...¹⁾
Hekuran Manekun²⁾ q'na vranë,
dymbëdhjet' xhandarë ç'i vranë.
Vajti lajmi në Tiranë
Fieri vau gjeneral Gjilarnë,
miknë e madh të Zogut të Parë,
që tha «Fierit t'i vemë zjarrnë,
me Fierin gjeta belanë».

1) Përsëritet pas çdo vargu.

2) Hekuran Maneku, pjesëmarrës në vrasjen e gjeneral Gjilardit në Kryengritjen e Fierit, 1935.

ME CIL MA ZURE MAZARANE

Me cil ma zure mazaranë?
Bir, Hysenj,¹⁾ o bir, o djalë!
Ma zure më Ali²⁾ aganë,
më shite kanë, more dogranë,³⁾
shite lopën, bleve gjerdanë.
Në fushën e Sukut
më rrihje nishanë,
i hipe pelës, shkove revan
vrate Ali aganë.

Suk

1) Hysen Tafa, fshatar fukara, vuante për bukën e gojës.

2) Ali agai, çifligar, e kishte fyter rëndë Hysenin dhe ai, për t'u hakmarrë, shati të vëtmin ka që kishte, bleu pushkë dhe vrou Ali aganë.

3) Dogranë — armë.

TE MËRKUREN NË SABAH

Të mërkurën në sabah
një kobure se ku ra,
lule Haxhi Demçja.¹⁾
O kobure, o dogra.
Haxhi, çark ta bënë shtëpinë
xhandarët me mylazinë.
Haxhi, vrave mylazinë,
xhandarët e qenit iknë.

Hekal

1) Haxhi Demçja, fshatar nga Hekali, kaçak i dënuar nga qeveria turke, rrethohet në shtëpinë e tij dhe, kur xhandarët i bëjnë thirrje të dorëzohet, u përgjigjet: «Unë jam i dorëzuar në shtëpinë time, prandaj urdhëro brenda, zoti mylazin». Kur mylazini u fut te porta, Haxhiu e la të shtrirë.

HAXHI DEMÇJA PA BAJRAK

Haxhi Demçja pa bajrak,
bëre sulm në sokak,
sulmove mbi turkoshakë.
I ngjite shkallët lart,
me të huajtë kishe inat.
I arrite në çardhak,
të vrarë i bëre shtatë.
E mbushe pazarin me gjak,
me gjak mbushe pazarë,
na nderove gjithë fshanë.

Hekal

1) Për vrasjen që bëri, Haxhi Demçja u dënuar 16 vjet burg. Fshati vendosi që ta mbante me bukë. Pas 14 muajve burg Haxhiu shpoi murin, vrapojnë turke, i mori pushkën dhe u arratis me pesë shokët e tij.

KËNGA E KAÇAKUT

As bandill, o mandilezi, as ore bandill,
puna jote derëzi,
natë e ditë po në pusi.
Do të vinj dhe unë me ty,
të fshinj ballin, ata flokët e zinj,
të mbush vezmet, o të bëjmë kërdinë,
të shporrim osmanllinjtë.

Libofshë

TRIME ISHTE MYZEQARJA

Një çupë fshati e lindi,
lindi një flori,
trime ishte myzeqarja
me revol' në gji.
Mori hakë për baban,
se s'kishte njeri.
Në dhe e shtriu qehajanë,
pashai bën çudi.
— Burgun unë le ta vuaj,
s'bëra poshtërsi,
më vjen keq për vëllanë
që e lë çilimi.

Rreth-Libofshë

IV

KUR TË RRITESH BËHU TRIM

Nina-nana, more bir,
fli se gjumi të bën mirë.
Rritu ti të tundet dheu,
bëhu trim si Skënderbeu.
Kur të rrithesh edhe ca,
kazmën, pushkën mos i nda.
Ti m'u rritsh, m'u bëfsh trim,
për Enverin, për Partinë.

Seman

VI

SI SKËNDERI SYSHQIPONJË

Nina-nana, more bir,
 fli se gjumi të bën mirë.
 Të bën mirë të rritesh-o,
 të kalosh vërsnikët-o.

{Të bëhesh i dashur, i fortë,
 si Skënderi syshqiponjë.

Hamil

KËNGË DJEPI

Nina-nana, ullulla, ullulla,
ta zerë gjumi djalin-o,
djalin-o, të voglin-o,
të vogël, të parritur-o,
në këmbë të pangritur-o.
Nani-nani të tund nëna,
të tund nëna të rritesh-o,
sa t'i shkoç vërsnikët-o.
Nani-nani, ullulla,
shkojnë zogat turmë-turmë,
venë të pinë ujë në lumë,
djalit tim t'i bien gjumë.
Ullulla, ullulla,
shkojnë zogat çetë-çetë
shkojnë të lahen në det,
djalit tim t'i bien shëndet.
Djalin na e zuri gjumi,
ju që shkoni e ju që vini
djalin tim mo e ngini.

Nina-nana, ullulla, ullulla,
djali im marshalla.
Juve njerëz që po shkoni
djalin tim mo e zgjoni.

Topojë

N I N U L L È

Llaj-llaj, ullullaj,
hesht, o xhan, ti mos më qaj,
të vafitë koka mu në majë,
u bëfsh trim si babai,
u bëfsh ushtar për vatan,
qentë shkopin mos të ta hanë.

Gorishovë

DJALI NËNËS, MARSHALLA

Djali nënës, mërralla,
o taja-tarnana.
Tunde hatë e tunde ditë,
o tarna-tarnana.
Që të na rritet ndonjë çikë,
o tarna-tarnana.
Ndonjë çikë e ndonjë thërrime,
o tarna-tarnana.
Porsi gishti i dorës sime
o tarna-tarnana.

Ndernënas

ATJE POSHTË MË NJË FUSHË

O atje poshtë më një fushë,
pashë, o ç'pashë, o një të bukur-o,
o, e bukura sa më pa mua,
çak e çuk e shpejtoi shatin-o.
— O ik, or djalë, se s'ta kam ngenë,
se vijnë na shohin shoqet-o.
— O shoqet na kanë parë gjithmonë,
o marshalla të dyve na thonë.

Grecalli

DY SORKADHE

Aty lart te port' e madhe,
dale, myzeqare, dale,
hyjnë e dalin dy sorkadhe,
dale, myzeqare, dale,
o njëra m'e vogël, moj,
tjetra m'e madhe,
dale, myzeqare, dale,
njérën do ta marr,
do ta bëj manare,
dale, myzeqare, dale,
ta gjezdis stane më stane,
dale, myzeqare, dale,
ta ushqej me bukëvale,
dale, myzeqare, dale,
qafëgjatë si sorkadhe,
dale, myzeqare, dale.

Fier

HIQE VALLEN

Një vajzë andej nga lumi
dy orë vallen ç'e tundi.
Tunde, moj, të marrtë lumi,
se shoqet i zuri gjumi.
Le t'i zerë nuk i dua.
Hiqe vallen ina-ina
sikur bie violina,
hiqe vallen lehtë-lehtë,
fustanbardhë fletë-fletë,
hiqe vallen me ngavash,
fustanbardha me mëndafsh.

Agimi

NË BAHÇENË TËNDE, MOJ

Në bahçen tënde, moj,
na mbika qershia,
në degët e saja, moj,
një zog vija-vija.
Sa bukur këndon, moj,
kur bie qendia,
një vajzë nga fshati, moj,
doli nga shtëpia,
qan hallet e saja, moj,
qan hallet e mia.

Seman

ZËRIN TA DËGJOVA

Zërin ta dëgjova,
kur ngjisje në shkallë
merak mos u bëj,
se ty do të marr,
Synë e zi të pashë
kur rrije në shkallë
fletëthirrja më erdhi,
unë do të shkoj ushtar.
Me leje do të vij,
e ty do të t'marr.

Cakran

SEVDAJA, SHOKË, SEVDAJA

— O pëllumb krahëbardhë,
ku ke qenë e ku ke dalë?
— Kam dalë nëpër mëhallë
për një vajzë që kam parë,
e kërkova nuk ma dhanë,
sepse isha fukara.
Sevdaja, shokë, sevdaja,
më e keqe se fukaraja.
Fukara le të isha,
po sevdanë mos të kisha.

Grecalli

YLLI I BUKUR

Ylli i bukur ndrin në qiel,
nepërkë e bukur në Fier.
Moj, nepërkë, gjeç belanë,
unë me ty e kam sevdanë
për fustanin që më mbanë,
si trimi që mban dogranë,
mban fishek e mban gjerdanë.

Baltëz

NA KA MBIRË NJË LULE

Na ka mbirë një lule
mu në mes t'oborrit,
pranë do t'i rri,
moj jasaman, amane,
sa më shpejt të rritet-o.
Taksimi më zuri,
moj jasaman, amane,
që të rri me plakat-o,
yzmet do t'i bëj,
që t'u marr uratat-o.
Na ka mbirë një lule
moj jasaman, amane,
mu në mes t'oborrit-o.
Kusuri më zuri,
moj jasaman, amane,
që të rri me nuset-o,
ato faqekuqet-o,
ato buzëburbuqet-o.
Na ka mbirë një lule,
moj jasaman, amane,
mu në mes t'oborrit-o,
sevdaja më zuri,

moj jasaman, amane,
që tē rri me çupat-o,
bilbil do tē bëhem
t'u këndoј mbi supat-o.

Grecalli

LERI LAJKAT, GOCE

Dyshemen' me mollë,
laurin' me thekë,
leri lajkat, gocë,
se s'të kanë lezet.
Të kërkova ujë,
më nxore sherbet,
leri lajkat, gocë,
se s'të kanë lezet.
Të kërkova bukë,
më nxore çyrek,
leri lajkat, gocë,
se s'të kanë lezet.

Marinëz

KU E GJETE DASHURINË

— O, pse mban sytë mbi mua,
çun, o more djalë?
— Unë i mbaj se ty të dua,
gocë, moj, vetullangjalë.
— O, ku e gjete dashurinë,
çun, o more djalë?
— Në arë kur mbillje farë,
gocë, moj, vetullangjalë.
— Prit sa t'i kallzoj nënësë,
djalë, o more djalë.
— Nënë e babë ne t'i pyesim,
por besën mos ta ndajmë.
— Djalo, mos u bëje merak
me prindërit fjalën do jap,
do punojmë bashkë me garë
kush të dalë më i parë.
Shokë, ushtar' të dy do jemi,
ku të dojë Atdheu do vemi,
do këndojmë, do hedhim valle,
për Partinë famëmadhe.

Seman

DY VAJZA NË ÇEZMË

Dy vajza në çezmë,
baluket mënjanë,
jarinani, nani,
sa të bukura janë...¹⁾
Njëra është ezmere,
tjetra borë e bardhë.
Njëra lan shaminë,
tjetra lan fustanë,
në mos njëren, tjetren,
unë do ta marr.
Me atë ezmeren,
kam hedhur sevdanë.

Verri

1) Përsëritet pas çdo dy vargjesh

KUR MË SHKONJE RRUGËS

Kur më shkonje rrugës,
pula pitikoshe,
zëri dallëndyshe,
fytërë bukuroshe.
Më shkonje në çezmë,
të lanje ca rrobe.
Zërin dallëndyshe,
fytërë bukuroshe,
më ujë më lajshe,
më sapun ferkëjshe,
zëri dallëndyshe
fytërë bukuroshe.

Marinës

DOLI NJË LULE NGA PYLLI

Doli një lule nga pylli,
burbululeja...¹⁾
Mbushte ujë te burimi.
— Mos i mbush enët plotë
je e vogël s'i mban dot.
Leri nja dy gisht më poshtë,
t'i mbush unë me borzilok.
Leri nja dy gisht më firë,
t'i mbush unë me trëndelinë.
Leri nja dy gisht më pak,
t'i mbush unë me zambak.

Grecalli

1) Përsëritet pas çdo vargu

BËHEM YLL E TË NDJEK PAS

- A ke marrë haber, moj lule,
se do vijm' të t'marrim-o.
- Haber mora 'dhe dëgjova,
më duket s'më japin-o.
- Do të marrë, moj ngjalë e lumiit,
do të marr me domosdo.
- Bëhem hënë hyj në re,
s'më merr dot, djalë more.
- Do të marr, moj ngjalë e detit,
do të marrë me domosdo,
do të marr në mes të miletit,
do të marrë me domosdo.
- Bëhem hënë e hyj në re.
- Unë pa marrë ty s'të le,
bëhem yll e të ndjek pas,
unë pa marrë ty do pëlcas.

Kraps

M'U DOGJ XHANI, M'U KËPUT

— M'u dogj xhani, m'u këput,
moj aman, aman...¹⁾
Për ty moj faqepambuk,
unë do bëhem zog i zi,
do fluturoj mbi çati.
Mbi çati të fluturova
dhe me gurë të qëllova.
— Më qëllove t'u thaftë dora!
— Nuk jam gjarpër e do të ha,
jam një djalë që kam sevda.

Petovë

1) Përsëritet pas çdo vargu

NA FOL ME GOJE

Në bahçen tënde
dyzetë rrënje mollë,
ç'na u rrit çupa
po na e bëmë me dorë.
— Mos ma bëj me dorë,
po na folë me gojë
se na shohin bota
kushedi çà thonë.
— Bota le të na shohin,
të thonë c'të duan,
ne njëri-tjetrin
më shumë do ta duam.

Fier

SYLARME, Ç'TA KAM SEVDANE

Një gardh i hollë në mes na ndan,
sylarme, ç'ta kam sevdanë.
Të dy qetë seç ngisnim nd' arë,
sylarme, ç'ta kam sevdanë.
Kjo dora jote, seç na hidhte farë
sylarme, ç'ta kam sevdanë.
Kjo linja jote mbulonte ugarë,
sylarme, ç'ta kam sevdanë.

Pojan

DIELLI MBULOI FUSHËN

Në atë konak ku rrige ti
është vapë e zagushi.
Bëj dua të fryj veri,
të ftohi gushë e gjë.
O moj ta kam sevdanë
për ata dy dhëmbët e rrallë.
Kur të pashë gushën-o,
dielli mbuloi fushën-o.
Kur të pashë ballin-o,
dielli u ngjit malit-o.

Grecalli

FRYN VERIU NGA DETI

Fryn veriu nga deti, nëno.
më rrëzoi shaminë,
m'u ngjin', moj nëne, m'u ngjin'.
M'u ngjin' dy djem, moj nëne
njéri është bandill,
më erdhën nga 'bahçja, nëne,
më zbuluan shtëpinë.
— Bjeru, bijë e nënës, bjeru,
bjeru me martinë.
— T'u thaftë gjuha, nëne,
si ta vrás bandill'?

Grecalli

Ç'MBJELL ASHTU

— Ç'mbjell ashtu, moj, ç'mbjell ashtu,
ç'mbjell ashtu, moj e vogëla?
— Borzilok, more, borzilok.
borzilok, more, në saksi.
— Ta këpus, moj, ta këpus,
ta këpus, ta vë në gji.
Se mban erë, moj, se mban erë,
se mban erë, moj, dashuri.

Fier

TRËNDAFIL I MALIT

- Ça kërkon andej-këndej,
trëndafil i malit-o?
- Kërkoj rrugën nuk e gjej,
manushaqe e fushës-o.
- Ça më jep ta dëftej,
trëndafil i malit-o?
- Të jap një herë faqen-o,
manushaqe fushës-o.
- Jo njëherë, po përherë.
trëndafil i malit-o.

Agimi

LULE BUFKA MENEKSHE

- Qasu këtu, pse rri atje,
lule bufka menekshe.
- Mirë jam këtu më bahçe,
o zambaku i prillite.
Se del babai dhe na sheh,
o zambaku i prillite.
- Të marrë unë e të fsheh,
lule bufka menekshe.

Kreshpan

NE KENDIM TE GJELAVE

Në këndim të gjelave
shkon trimi i syzezave,
shkon e shkon duke kënduar.
— Mos këndo, qofsh i bekuar,
se më ndodhet babai zgjuar.
Sa të vë baban' në gjumë
me ty do të vij dhe unë.

Pojan

TRËNDELINË, DIL TE PORTA

— Trëndelinë, dil te porta,
trëndelinë moj...¹⁾

Dil te porta po të them,
se po shkojnë një sërë djem,
thuaj se cili të pëlqen.

— Ai djal' vetullkalem.

— S'jam kalem për të shkruar,
po jam djal' për t'u martuar.
Nuk jam djalë që tund shaminë,
po jam djalë që bëj ushtrinë.

Seman

1) Përsëritet pas çdo vargu

THEM TA MARR

Ç'është ai zjarr atje në mal,
qaj, moj zemra ime, qaj...¹⁾
Ai nuk ish zjarr, po djalë beqar,
them ta marr, them mos ta marr,
them të pyes një herë babanë,
— Merre, bijë, mos iu ndaj
të mirin s'e gjen kollaj.

Kallm

1) Përsëritet pas çdo vargu

QEPJA E NISHANIT

O qy, moj, nishani i parë,

ty djal' të vaftë mbarë,

si gruri që hedh në arë,

hedh një dorë e merr një barrë.

Dy shamitë çifte-çifte

lidhi, moj, zgjidhi, moj,

sa të vij' djali që nga ara,

të bjerë shamitë lara-lara,

lidhi, moj, zgjidhi, moj.

Xixëllon xixa në mal, moj, xixëllon,

s'ish xixë por ish nishan, xixëllon,

po qepja nishan për djalë, xixëllon.

Shkoi babai dhe e pa, xixëllon,

marshalla mua më tha, xixëllon.

Xixëllon xixa në fushë, xixëllon,

s'ish xixë por ish nuse, xixëllon,

do qepësh nishan të bukur, xixëllon.

Shkoi nëna dhe e pa, xixëllon,

marshalla mua më tha, xixëllon,

nuse për punë e për djalë, xixëllon.

KËNGA E LAJMËSIT

O qy lajmësi nga rerëza — mustaqe gjilpërëza,
o qy lajmësi nga lëndina — pa çorape, pa opinga,
o qy lajmësi rrecka-rrecka — mbushur këmbët me
thërrrecka.

Lajmësi lezet nuk ka, kokën plot me lakëra.
Ik, o lajmës, o faqezi, jemi marrë me dashuri.

Marinëz

NUSE GUSHA FARFURI

Pse dridhesh si gjarpëri,
nuse gusha farfuri,
ty njeri s'të ka zili,
nuse gusha farfuri.
Ma ke shtatin si selvi,
nuse gusha farfuri,
ma ke syrin si ylli,
nuse gusha farfuri,
ma ke buzën si kuti,
nuse gusha farfuri.

Grecalli

SA GEZIM QE KA KETU

Sa gëzim që ka këtu,
o shokë...¹⁾
Marton nëna gëzimin e parë,
gëzimin e parë, lule në ballë.
Janë mbledhur miqësia,
miqësia; shoqëria,
gëzimin tonë e urojnë,
jetë të lumtur të kalojmë,
djem e vajza t'i martojmë.

Grecalli

1) Përsëritet pas çdo vargu

KE MARR' DJALIN MYZEQAR

Moj unaza rreth me ar,
lumja ti ç'burrë ke marrë...¹⁾
Ke marr' djalin myzeqar,
për çdo ditë punon në arë,
me shokët është në garë,
trim, punëtor e sypetrit,
djersën derdh në arë përditë.
Trim, punëtor e xhevahir,
në punë shkon që pa gdhirë.

Fier

1) Përsëritet pas çdo vargu

NË RRËZË TË MALIT SHKOVA

Në rrëzë të malit shkova
një zë bilbili dëgjova,
mbajta kalin dhe qëndrova.
— Do vish vet' a të marr unë?
— Unë vi, po nuk më lënë
Ty, moj nënë, të kam thënë,
mos më ço ti më me dhënë,
se ata pa marr s'më lënë.

Kallm

Këndohet në dasmë kur shkojnë krushqit të marrin nusen.

TRËNDAFIL I KUQ NË LËMË

Trëndafil i kuq në lëmë,
moj aman, aman...¹⁾

— C'janë këta njerëz që rrinë në këmbë?
— Janë njerëzit e nuses tënë,
rrinë në këmbë e derdhin lot,
u morëm të bijën sot.

Kutë

1) Përsëritet pas çdo vargu

DO VISH TI, MOJ VAJZE E VOGEL

- Do vish ti, moj vajz' e vogel,
do vish o me ne, do shkosh o me ne?
Ne kemi një mal pérpara
vallë, moj, do vish dot,
vallë, moj, do shkosh dot.
- Zog me krahë unë do bëhem,
malin ta kaloj,
dhe me ju do vij,
dhe me ju do shkoj.
- Ne kemi një lum' pérpara
vallë, moj, do vish dot,
vallë, moj, do shkosh dot?
- Peshk me hala unë do bëhem,
lumin ta kaloj,
dhe me ju do vij,
dhe me ju do shkoj.
- Ne kemi një pyll pérpara,
vallë, moj, do vish dot,
vallë, moj, do shkosh dot?

— Sëpatë me vete unë do marrë,
pyllin ta rralloj,
dhe me ju do vij,
dhe me ju do shkoj.

Zharrez

MIRË SE ERDHE, MOJ NUSE

Gratë: Atje poshtë tek shkoza
këndonin dy zoga,
kërcenin e këndonin
një djalë po martonin.

Djali: Nuse, mos m'u dridh si mëze,
moj nuse,
se sonte do flemë bashkë,
moj nuse,
si lule.

Lumja ti, ku erdhe sonte,
lum nuse,
o lule.

Tek dhëndri si nuri,
lum nuse,
lule je.

Mirë se erdhe
këtu tek ne.

Mollaj

LIRIKE DASME

Djali — O moj molla grezhda-grehzda,
pse më mbajte me gënjeshtra
gjer aty sa erdhi vjeshta.

Vajza — Vjeshta hyri e vjeshta doli,
djalë more.

moj shoqe, djalë more.

Të dy — Ne merakun na e nxori,

Kori — Vjeshta hyri e vjeshta doli,
moj vajzë e re...
O djalë more.

Edhe pemët na i voli,
moj vajzë e re, o djalë more,
ne merakun na e nxori
moj vajzë e re, o djalë more,
nusen e djalit e solli
moj vajzë e re, o djalë more,
ne të gjithëve na gëzoi,
djalë more, moj shoqe,
dhe më shumë na bashkoi,
djalë more, moj vajzë e re.

Gorishovë

DO VISH ME NE

- Do vish me ne, apo jo,
moj shelege vogël-o,
lege, moj lege vogël-o.
Do të shpjete në qytet
do të vesh si të duash vet',
do banojmë në apartament.
— Nuk vij se qejfi s'ma do,
ku do t'i lë shoqet-o,
dua të rrite me to,
të shëtis lëndinave.
— Do vish me ne, apo jo,
të zgjatim hekurudhat-o,
të lartojmë kullat-o,
të hapim tarracat-o.
— Do të vij me domosdo
se na mëson Partia jonë
atdheun ta lulëzojmë.

Gorishovë

O ÇOBAN, UNË TY TË DOJA

— Sharkun nën shtrungë e shtrova
më dhëmb zemra, qysh durova.
Kam tre vjet që qysh durova,
— Ç'ke, o djale, që je sëmurë,
që t'i them dhe unë sat ëme.
Mos erdhi ujku u trembe,
mos të humbën gjysmat e dhënve.
— Djali që ka rritur nëna
është trim s'i tundet këmba.
Kush i shkel te stani brenda,
ka rrezik t'i çahet zemra.
Ç'pate, moj, bardhoshe bardhë,
katër vjet ma dogje xhan.
Në ëndërr të kisha parë
thash' se dëgjove babanë.
Në do djale për të shpëtuar,
të mos vuash, si ke vuar,
kur ke vapë, mos fli mbuluar,
mos shih ëndërr, kur je zgjuar.
— O çoban, unë ty të doja
s'kisha natë t'mos ëndërroja,

tani shkollën e mbarova
dhe për ty çoban mendova.

— Unë ta them troç, moj vajzë,
se kurrë mendja s'ma kish marrë,
ti, studente në Tiranë,
të mendoje për çoban'.

Sytë tek shtegu më ngrinë,
zbardhi mali dhe vërria,
zemra e ngrirë më shkru
ajo që desha, arriu.

Nusja jonë brigadiere,
doktoreshë, veterinere.

Rromës

NUSJA QË VJEN KËTU

Kjo nusja që vjen këtu,
thot' se jam më mirë nga ju.
Hesht, moj nuse, mos gënje,
ti nuk je më e mirë nga ne,
në na i shkofsh nga bukuria,
ta shkojmë nga dituria.

Vreshtas

1) Këndohet kur zbret nusja nga graria.

PO VJEN BIJA NË TË PARË

Ç'është ajo që po afron,
o limon, ore limon...¹⁾
Në të parë, bija jonë,
paska dalë nuse si zonjë.
Vjen nëpër bahçe me ftonj,
era borzilok i njomë,
Na vjen bija në të parë,
po sjell kulaçin me palë
edhe revanin' me arrë.

Klos

1) Përsëritet pas çdo vargu.

Këndohet kur yajza kthehet në të parë te prindërit në krye të javës ose në dy javë sipas zakonit. Ajo sjell tek prindërit gatime si revani, kulaç, çyrek etj.

MOJ SYZEZA VETULLGOZHDE

Moj syzeza vetullgozhde,
moj aman, aman...¹⁾
Turru lart, turru poshtë,
nëpër bahçe, nëpër kopsht,
nëpër borzilok të njomë.
Borziloku na çoi farë,
u bë nusja për të marrë.
Kush ta marrë, allamedet?
Vete dhëndri me dyzet vetë.
Të dyzetë me daulle,
kjo nusja vellon me lule.

Suk

1) Përsëritet pas çdo vargu
Këndohet kur nisen krushqit e djalit për të marrë nusen.

HIPA LART MBI ÇARDHAK

Shkapërceva dy-tri male,
ja lule, ja lule...¹⁾
Dy-tri male dhe një fushë,
hipa lart mbi çardhak
pashë një nuse me duvak,
vajta e zbulova pak,
kur i pashë vetullat çark,
u drodhti zemra në bark.
Kur i pashë kokën me bojë,
m'u drodhti gjuha në gojë,
kur i pashë syrin e zi,
m'u bëti mendja veri.²⁾

Suk

1) Përsëritet pas çdo vargu

2) Këndohej kur vinte nusja.

PO VIJNË TË TË MARRIN—O

- Burburisin malet-o,
moj nëna ime.
- Po vijnë të të marrin-o,
moj bija ime.
- S'kam se ku të fshihem-o,
moj nëna ime.
- Në saksi me borzilok,
moj bija ime.
- Esht' i shkurtër s'mbulon dot,
moj nëna ime.
- Hidhi ujë të rritet-o,
moj bija ime.

Pojan

1) Këndohet kur vijnë krushqit në shtëpinë e nuses.

DJALI LE T'MUNDOHET—O

— Mos e bëj qejfin qeder,
moj llokumja me sheqer,
se vjen vjehrri e të merr,
moj llokumja me sheqer.

— Vjehrri mos mundonet-o,
se është larg e lodhet-o,
bie shi e njomet-o,
s'ka rroba të ndërronet-o.

— Mos e bëj qejfin qeder,
moj llokumja me sheqer,
se të vjen djali e të merr,
moj llokumja me sheqer.

— Djali le t'mundonet-o,
është afër e s'lodhet-o,
bie shi e s'njomet-o,
ka rroba e ndërronët-o,
ka jorgan t'mbulonet-o.

Baltëz

PSE MË MBAHESH KAQ ME SQIMË

Pse më mbahe kaq me sqimë,
moj nuse, moj lule...¹⁾
Ne të njohim, ne të dimë,
ke veshur fustan nusërie,
sot e ke, nesër s'e ke
do bëhesh shoqe me ne.

Pojan

1) Përsëritet pas çdo vargu.
Këndohet të dielën në shtëpinë e dhëndrit kur ka ardhur nusja.

QESH E VOGËL E U RRITA

— Atë ditë që u nda dita
Sofije,¹⁾ moj motër-o,
tyja seç të hyri frika,
Sofije, moj motër-o,
të ranë lotët pika-pika,
Sofije, moj motër-o.
— Qesh e vogël e u rrita
nënës unë iu mërzita.

Pojan

1) Emri i nuses
Këndohet të shtunën në darkë.

ERDHI NUSJA NË OBORR

Erdhi nusja në oborr,
shtati i nuses si vapor.
Hyri nusja në shtëpi,
shtati i nuses si selvi.
Hyri nusja në konak,
shtati i nuses si bajrak.

Grecalli

HËNA ME RREZE NË DORE

Nisëm, nisëm djalin (diellin)
të na marrin hënën.
Hëna me rreze në dorë
të ndriçojë këtë oborr.
Hëna me rreze në gji
do ndriçojë këtë shtëpi.
Hëna me rreze në ballë
do ndriçojë këtë mëhallë.

Grecallji

HAPE VALLEN MOS E MBYLL

Hape vallen, mos e mbyll,
moj xhane, mos e mbyll.
Në mes ballit ke një yll,
moj xhane, ke një yll.
Yll e hënë seç jam vetë
me burrin do shkoj jetë,
moj xhane, do shkoj jetë.

Fier

AS MË LE TË HYJ NË BAHÇE

- As më le të hyj në bahçe,
xhan, ore bahçevan.
- Ç'a do bësh në bahçe ti,
t'u bëfsha kurban.
- Do të mbledh ca manushaqe,
xhan, ore bahçevan.
- Ç'i do manushaqet ti,
t'u bëfsha kurban.
- I dua t'i bëj gjajtan,
xhan, ore bahçevan.
- Ç'e do moj, gjajtanin ti,
t'u bëfsha kurban.
- E dua për nusëri,
xhan, ore bahçevan.
e dua për dashuri,
xhan, ore bahçevan.

Fier

I THONË SHOKËT U TRASHEGOFSH!

Qan bilbill n'odët-o,
është djali i vogël-o,
qan e lan djalérinë,
djalérinë s'e gjen më kurre,
se i thonë burrë me grua.
I thonë shokët u trashëgofsh,
paç djem e vajza plot,
rrofsh dhe i martofsh,
M'i martofsh këtu në fshat,
plastë ai që ka inat.

Grecalli

MIRË SE ERDHE BURBUQE—HËNA

Mirë se erdhe burbuqe-hëna,
mirë se erdhe këtu tek nëna,
mirë se erdhe, të lumtë këmba!
Këtu tek shtyre kokën-o,
këtu të rënçin flokët-o,
këtu tek shtyre këmbën-o,
këtu të rënçin dhëmbët-o,
këtu tek shtyre ijet-o,
këtu të rënçin brinjët-o.

Ndernënas

ME SE ZIHET BRUMËT

Jançë-jançë brumët-o,
me se zihet brumët-o,
me mjalt' e me qumësht-o,
me një sitë e me një fre,
me një magje, me një qe.
Jançia me dy trasta në dorë,
një me akull, një me borë.
Jançia lart në tra,
po shastisen burra-gra.
Shpejt, o Jançë, o syzi,
shpejto, shpejto se u gdhi.

Zharrëz

LULE MIDIS TË TJERAVE

Vajta në çezmë të mbush ujë,
moj aman, aman,
seç m'u thye qelqja në rrugë,
moj aman, aman.
Le të thyhet, oj medet,
se mua vjehrri nuk më flet,
më ka nuse me kimet,
më ka marrë me dëshirë të vetë,
lule midis të tjeravet.

Agimi

MOJ MOLLË E KUQE, TË MBAJTSHA NË XHEP

Tri sërë urupa, varur në jerek,
hajde, moj mollë kuqe, të mbajtsha në xhep.
jerekun me ar, moj, ta kam bërë unë vetë,
hajde, moj molle kuqe, të mbajtsha në xhep.
Po s'të deshi vjehrra, moj, të do lala vetë,
hajde, moj molla kuqe, të mbajtsha në xhep.
— Ik, o more djale, se ke lajka shumë,
se jam e parritur edhe dua gjumië.
Gjumin që ke bërë, lëre te jot ëmë,
vendin që ke ndenjur mate me pëllëmbë.

Pojan

MOJ E VOGËLA NË LIS

Moj e vogëla në lis,
moj e vogëla,¹⁾
ti me vjehrrën mos u nis,²⁾
se ajo të telendis,
se s'të ka as farë, as fis,
po nisu me djalin-o
se ai ty të do,
se të do, të lajkaton,
ç'të do zemra të dhuron.

Baltez

1) Përsëritet pas çdo vargu
2) U nis — mos bëjë fjalë

JO, MOJ, JO, SE BEJ SHAKA

Lavdëron viti senenë,
lavdëron.

Lavdëron vjehrra të renë, lavdëron,
nusja ime gjeraqinë,
një herë në ditë e fshinë shtëpinë.

Kam nuse si vapor,
një herë në javë e fshin oborr'.

Kam nuse sqimatare,
bukë e gjellë s'më ha fare.

Kur ha mbahet me t'madhe
një qyp dhallë, dy feta djathë.

Jo, moj, jo, se bëj shaka,
e kam nusen marshalla
si gota në tabaka.

Grecalli

HAJDE NJË NATË TEK UNË

- Hajde një natë tek unë,
o e zeza unë.
- Kam këto dhën e kam këto dhi,
o i ziu unë.
- Bjeri një natë në shtëpi,
o e zeza unë.
Lëri një natë në mal,
o e zeza unë.
- I ha ujku me çakall,
o i ziu unë.
Moj e shkurtura një pëllëmbë
ti ke ngjarë nga jot ëmë.
- Ku e njeh ti, të tim ëmë?
- E shiste misrin me shtëmbë.
- Moj e shkurtura një shuplakë
ti ke ngjarë nga yt atë.
- Ku e njeh ti të tim atë?
- E priste bukën me sëpatë.
- Moj e shkurtura një bërzhik
ti ke ngjarë nga yt gjysh,
hante bukë me këlyshë.

Seman

O KJO ANË E LUMIT

O kjo anë e lumi
ka bilbila shumë
vjen e ëmë e nuses
na bën rixha shumë:
— E kam vajzën të vogël,
mos m'i jepni punë
se e kam të njomë
dhe më lodhet shumë.
— Në e kishe të vogël
mos i jepje burrë
ne e duam për punë,
nuk e duam për gjumë.

Pojan

Këngë dasme humoristike.

MË NGORDHI GOMARI

Më ngordhi gomari mua,
kërr-kërr, karkaleci,¹⁾
buj- buj, bujbuzhina.²⁾
Më qortoi babai mua,
pse s'ma dhatë lëkurën mua
ta bëja jorgan për grua.
Më qortoi xhaxhai mua,
pse s'ma dhatë plëncin mua,
ta bëja manto për grua.
M'u zemërua kunati mua,
pse s'm'i dhe veshët mua,
t'i bëja shapka për grua.
M'u zemëruar burri mua,
pse s'm'i dhe dhëmbët mua,
t'i bëja florinj për grua.
M'u zemërua vëllai mua,
pse s'm'i dhe zorrët mua,
t'i bëja gjerdan për grua.

Kutë

1) dhe 2) Përsëritet pas çdo vargu.

TUNDU SHKUNDU, KUMBULL—O

Tundu shkundu, kumbull-o,
të na bien të thatat-o,
t'na i mbledhin plakat-o.
Plakat zun' po ziheshin-o,
zun' e zun' po rriheshin-o,
bam e bum kurrizit-o,
me kopan t'orizit-o.
Të na bien t'kuqet-o,
të na i mbledhin nuset-o,
Nuset zun' po ziheshin-o,
zun' e zun' po rriheshin-o,
bam e bum çemerit-o,
me kopan t'sheqerit-o.
Të na bien të émblat-o,
të na i mbledhin gocat-o.
Gocat zunë po duheshin-o,

Fier

KËTA KRUSHQ BUJARË

Këta krushqit bujarë–bujarë,
ca me kuaj, ca me gomarë.
Këta kuaj pa samarë,
samar' farë sharqiri
zingji lëkurë vidhi,
këto frera gjalmë liri.
Këta krushqit pse s'këndoijnë?
Kanë kuajt, u çalojnë,
kanë gomarët u rënkojnë.

Roskovec

KËNGË HUMORISTIKE PËR NUSEN E DHËNDRIN

— Nusja jonë e mirë e mirë,
dhëndri juaj si kec i shtyrë,
nusja jonë kallëp sapuni,
dhëndri juaj turi majmuni,
nusja jonë lule mali
dhëndri juaj më fre pe kali.
— Jo, jo, jo, së bëm shaka
dhëndri qenka marshalla.

Pojan

Këndohet të dielën në shtëpi të nuses kur ka vajtur
dhëndri për ta marrë.

S'E DINJA SE KISHIT DASME

S'e dinja se kishit dasmë,
s'e dinja,¹⁾
të merrnja një shoshë me lakra
të gostisja këto plaka,
S'e dinja se kishit dasmë,
të merrnja longar me vete,
të bëja nuset me vete
ato nuse faqekuqe,
S'e dinja se kishit dasmë,
të merrnja defin me vete,
të bënja çupat me bejte,
ato çupa faqekuqe,
faqekuqe, buzëburbuqe.

Pojan

Këndohen tërë javën e dasmës

RRUSH I BARDHË I DENDUR

Rrush i bardhë i dendur-o
bën verën të ëmbël-o,
pinë sa dehen pleqët-o,
sa harrojnë takijet-o
andej nëpër hijet-o.
Rrushi i bardhë i dendur-o
bën verën të ëmbël-o,
pinë sa dehen plakat-o,
sa harrojnë këto napat-o
andej nëpër krabat-o.

Ndernënas

KËNGË PËR JETËN E MJERUAR
TË SË KALUARES

KORBA, NËNE, KU MË DHE

— Korba, nëne, qyqja, nëne, ku më dhe,
më dhe poshtë në Myzeqe,¹⁾
lëronin me kua j, mbillnin me qe,
shtypnin plisa me varre,
ndanin bukën me ise,
ndanin dhallën me xhevze,
kokën në rrug os, moj nene,
këmbët në mbërdhe.
Ata s'kishin xhevze, moj nene,
të pinin kafe,
vinte breshka, nene,
drejt e në qos hje.

Grecalli

1) Kjo këngë këndo hej para Çlirimtit kur gjendja në Myzeqe ishte mjaft e rëndë.

PLEQTE NA TREGOJNË DERTE

Pleqtë na tregojnë derte,
jemi rritur në të keqe,
në bejlerë e në oxhaqe,
në dorë kabash qelqe,
duke thënë lepe-peqe.
Na grabitën qerratenjtë,
agallarë dhe bejlerë,
mbetëm pa bukë e ujë hiç,
këmbëzbathur, lakuriq.
O burra, o fëmijët tanë,
të shfarosëm ben' e aganë,
s'na lanë nder e vatan.

Frakull

HYZMEQAR DERË MË DERË

Që ditën që kam të lerë,
qaje, moj nëne, qaje fatin-o,¹⁾
hyzmeqar derë më derë,
dhe për mesi një litar,
opinga nuk kisha fare,
në kokë fëste të çjerrë,
hyzmeqar derë më derë.

Kutë

1) Përsëritet pas çdo vargu.

BEU S'MË BËRI PJESE

Në ditët e para të majit,
un' i mjeri,
kopshtin e bëra ugar,
e mbolla misër të bardh',
e mbolla misër për farë,
e punova gjithë behar',
erdhi beu me qehajanë,
misrin e ndanë të dy bashkë.
Hodha sytë tatëpjetë
mos më bënjin mua pjesë.
U ngrit gruaja në mëngjes,
këta fëmijë me se t'i mbledh,
beu s'më bëri mua pjesë.

Zharrëz

U SËMURE, S'T'U GJEND ILAÇI

Ore, halli yt, ore Dhimitraq,
ç'u sëmure e s't'u gjend ilac.
O Dhimitraq, o djalë i vetëm,
si ty nëna nuk ka tjetër.
Nëna bëri dasmë,
të gjithë miqtë i ftova.
Priste nuse, nëna
dhe nuse nuk mora.
O kjo ditë e zezë
që po shkojmë ne,
të là ty të dergjesh,
të tretesh në dhe.

Bishan

TIRE—SHTIRE LIRIN—O

Tire-shtire lirin-o,
furkëzo, drugëz-o,
drugëzo, furkëz-o,
tire-shtire mirëz-o,
se siç tjerim lirim-o,
tjerim, shtjerim hallet-o,
hallet, dertet e dynjasë,
të dynjasë, të fukarasë,
tire-shtire lirin-o.

Grecalli

BLUAJ, O MOKËR-O

Bluaj, o bluaj, o mokër-o
misrin nga një kokërr-o,
të gatuajmë lakrat-o,
të rrisim fëmijët-o.
Ndaje mirë misrin-o,
se nuk kemi tjetër-o,
një qese e para shpi
mban të rritur e fëmi.
Bluaj, o bluaj, o mokër-o
misrin nga një kokërr-o.

Mbrostar

TË RRI TI NËNA PA BUKË TY

T'rriti nëna barkun that, o bir,
djal' i nënës, shpirt' i nënës, bir,
të dha nuse si flori,
të varfër si ti.

Atë ditë dasme
oh, seç ramë në zi,
njerëzit e këtij beut
seç të vranë ty,
se një ditë vjeshte
i zure pusi,
beun le të vrarë
mbi kalin dori.

Nusja mor' haberin
erdh të qajë ty:
u mblodh i gjithë fshati
të marri hakën, bir!

Grecallia

Kjo ngjarje ka ndodhur rrëth viteve 1913-15 në Myzeqe anës lumit (Belinë-Metalli). Pronari i asaj zone, Xhevati Libohova i parë, është vrarë me thika nga fshatarët për hak-marrje të vrasjes së dhëndrit që bën fjalë kënga.

JAM NJË BUJK ME AGANE

Oh, jam një bujk e me aganë,
lemë, o zot, o lemë të rroj!...¹⁾
Kam një ka sa ngas në arë,
me bukë vete gjer në janar,
pastaj shkoj e blej në pazar.
Sa laj të tretë e laj të dhjetë,
laj bekçinë me gjithë myftar,
laj priftin me gjithë qishari.
Kam një dele sa për dhalë,
një xhezve me dy filxhanë,
një kusi e një sahan:
Kam shtëpinë të rënë mënjanë,
vrima-vrima në çdo anë,
hyjnë breshkat radhë-radhë
si sultani me ushtarë,
lemë, o zot, o lemë të rroj!

Seman

1) Përsëritet pas çdo vargu.

NUK E KAM NGA PLEQËRIA

- Poqa një plak në udhë.
- Hajde, vajzë, të marr unë.
- Jo, je plak, nuk të dua,
ti je plak e s'bën për mua,
ti kurrizin e ke të thyer.
- Jo, e gjeç nga perëndia,
nuk e kam nga pleqëria
isha hyzmeqar i ziu unë
më çoi beu për të prerë dru.
Vajta preva një lis të thatë
lisi ra më zuri mua
dhe më theu kurrizin mua
unë, vajzë, ty të dua.
- Jo, ore, se nuk të dua,
ti dhëmbë e dhëmballë s'ke.
- Vajta një ditë si hyzmeqar
t'i zija beut kalin hat,
ai më ra me këmbë të parë,
më theu dhëmbë e dhëmballë.

Grecalli

KËNGË TË MOÇME NIZAMI E KURBETI

Ç'U SHKËPUT NJË SHKËMB NGA MALI

Ç'u shkëput një shkëmb nga mali,
o bilbil i bukur-o,¹⁾
zunë kaponjtë dhe po këndoijnë,
zunë ushtarët dhe po shkojnë,
djalin tim nuk e dërgoj,
do ta rris, do ta martoj,
për të huajt mos luftojë,
por vatanë e tij të mbrojë.

Cërilë

1) Përsëritet pas çdo vargu.
Këngë për ikjen e djemve nizam,

M'U PRETË, O KËMBË, M'U PRETË

M'u pretë, o këmbë, m'u pretë,
than' që erdh llot e shkretë,
të na mbledh-o këta djemtë!
Jalla, u shofsh, moj Portë e Madhe!
Më të ryr' je e kollajme
më të dalë, s'del dot fare!
Vjen halldupi me shallvare
na bie një torbë të madhe
bytym me cyla gjysmare
si nepërka kokëlarne.¹⁾
Ç'u bënë djemtë vargje-vargje
ca me guna, ca me sharqe
ç'i mbajnë tre sahat në këmbë,
ç'i pyesin pér babë e pér nënë.

Lapulec

Komisionet ushtarake turke përdornin disa si cyle prej druri në masë të një cigarishteje, në këto cyle futnin letra bosh e plot, atij që i binte letra e shkruar thuhej se i ka rënë llota pér të shkuar ushtar; cylat i bënин me një kokë të gdhendur e të stolisur, po djemve kjo u dukej si kokë nepërke që do t'i helmonte.

KUR DO T'I VEMË TË SHKRETIT

O ju pamporët e detit,
selam bëni memleqetit¹⁾)
nga këta djemtë e kurbetit,
kur do t'i vemi të shkretit.
Kush të ketë babë e nënë
të qajnë lloinë tënë,
mbemë pa dorë e mbemë pa këmbë,
e kemi punën të rëndë,
dymbëdhjetë sahat në këmbë.

Kutë

1) Vendi i lindjes

O MOJ KOKË, MOJ QENE

O moj kokë, o moj qene,
që s'dite për veten tënde,
erdhe me një gjysmë mënge,
ishte mënga e sat ëme,
u të hëngërt atë mëndje.
Mbërthe qetë për parmënde,
mbill e korr në tokën tënde,
pashait jepi grusht dhëmbve!

Gorishovë

JAM NISUR NË KURBET

— Ku je nisur e do vec,
o djalosh këmishëzi.
— Jam nisur në kurbet,
o moj vetulla mazi.¹⁾
— Atje do vij dhe unë,
o beqar këmishëzi.
— Është larg e s'vjen dot,
o moj vetulla mazi.
— Bëhem mollë, futem më gji,
o beqar këmishëzi.
Mos harroj e të kafshoj,
o moj vetulla mazi.

Gorishovë

1) Vetulla mazi — vetull zezë.

MË ERDHI DJALI NGA KURBETI

Më mbeti një merak në zemër,
moj, nënë, më mbeti,¹⁾
më erdhi djali nga kurbeti,
kur erdhi atje s'më gjeti,
më gjeti me zoga deti,
mor dyshekun e ra e fjeti.
Kur u ngjit llule xheneti,
mollë e kuqe rënë nga xhepi.

Verri

1) Përsëritet pas çdo vargu.

PORSA DOLA TE GURI I BARDHË

Oi, porsa dola te guri i bardhë
m'u mbush zemra me të qarë.
Porsa dola te guri i prerë,
m'u mbush zemra plot me vrerë.
Porsa dola te guri i zi,
fshiva llojet me shami.
Oi, vrarë e prerë, bërë kërdi,
therur njerëzit si bagëti.

Libofshë

KOPSHTI IM MBETI LËNDINE

Zunë gjelat po këndojojnë,
o bilbilo,¹⁾
zunë yjet e po rrallojnë,
zunë kurbetçinjtë e po shkojnë.
Tërë shkojnë e tërë vijnë,
burri im harroi shtëpinë,
kopshti im mbeti lëndinë,
ka mbirë bar' e trëndelinë,
vijnë barinjtë kullosin bagëtinë,
mbushin duart me trëndelinë.

Ndernënas

1) Përsëritet pas çdo vargu

MINE, TË PASKA ZËNË LLOTA

Mine, të paska zënë llota,
të lidhç dy shami korba,
të dalç e të qaç te porta,
moj, që të dëgjojnë bota.
Edhe bota të dëgjuan,
erdhë shoqet të rënkuani.
— Po pse qan, o moj gëlonjë?
— Jam sëmurë, kush ta besonjë.

Drizar

DERI TE PORTA DOLA E PËRCOLLA

- Cullufet e tua gjethe trëndafili,
nuk të erdhi keq, kur të iku bandilli?
- Deri te porta, dola e përcolla,
në mes të oborrit u kthyesh e shikova,
në shkallën e dytë vajta dhe qëndrova,
atë qyqe nënë u çuash e pushtova,
nga inati i botës pikë loti nuk çova.

Ndernënas

MË VJEN BURRI NGA KURBETI

Çfarë ka që rënkon deti,
moj nënë, moj nëne?¹⁾
Më vjen burri nga kurbeti.
Do të dal e do ta pres
me shami të kuqe në brez,
do ti fshij ballin me djersë,
do ta laj atë qejfli,
do ta kthej në shtëpi,
do t'i shtroj verë e raki,
do t'i pres atë shalqi,
zemërkuq e farëzi.

Roskovec

1) Përsëritet pas çdo vargu

M'U QEPE, RROBË E MAVRISE

M'u qepe, rrob' e mavrisë,
shtatë vjet kush do të grisë?
Kjo rrobë shum' e rëndë,
të mban tre sahat në këmbë,
sa harron baba e nënë!
Ma pruri shpirtim në dhëmbë.
Qani, nëna, sa të shëmi,
mundimin e djemve që bëni,
u vate për dhjamë qëni.
u la pa bina dushmëni.
— O dushman, të rëntë zjarri,
o të rëntë anembanë,
se na shove djemtë tanë,
ca redif 'e ca nizamë,
gratë e nënët ku i lanë?

Drizar

MJERË SYTË E MI Ç'KANË PARË

O më një mal, në dy male,
 o moj lele,¹⁾
mjerë sytë e mi ç'kanë parë,
o, kanë parë një trim, moj, të vrarë,
u mblodhën zhgabonjat po e hanë.
— O hani, hani sa të doni,
o syn' e djathëtë të ma ruani,
se jam trim e më shëmtoni,
Kam një nënë, të zezën nënë,
del e qan lëmë më lëmë.
Kam një motër, të zezën motër,
del e qan kodër mbi kodër.
Kam një grua, të zezën grua
del e qan krua më krua.

Marinëz

1) Përsëritet pas çdo vargu.

PASQYRA E LËNDËS

I

Do këndoj s'do pushoj fare	3
Yll pér popullin e Partinë	4
Kjo Hoxhara jonë	5
Mes pér mes luginës	6
Moj Shqipni, kala e fortë	7
Kudo si fanar na ndrite	8
Lumja ti moj Grecallli	9
Hidhe vallen, myzeqarkë	10
Punojmë të lumtur pér jetën e re	11
O në Fierin tonë, lulëzonjeta e re	12
O Parti, o yll i ndritur	13
Denancohet sot - traktati	14
Pér gratë myzeqare	15
Sa lezet të paska pushka	16
E para sulmuese dole	17
Hidhe vallen lehtë-lehtë	18
Shqipëri tokë floriri	19
Bilbili kur zbret nga Myzeqeja	20
Valle e kënduar grash	21
Shkoi në punë vasha	22
Pa shikoni Shqipërinë	23
Trimja nuse, Mallakastër	24
Shumë e zonja u tregove	26
Në çdo vepër djersa jote	27

E lehtë si flutur	28
U ngrit pa zbardhur dita	29
Këngë për pusin 542	30
Dritë paç, o moj Parti	31
Ani, mirë po kcen, moj çika kosovare	32
Fshatin do ta lulëzojmë	33
Vajzat tona	34
C'ke bilbil që nuk këndon	35
Shqipëri zemëruane	36
Të gjithë ne jemi ushtarë	37
Populli vetë po i harton	38
Të punojmë bashkë në arë	39
Sot je bërë nuse e re	40
Vazhdimesht rrisim prodhimet	41
Fshati i myzeqesë sot po lulëzon	42
C'kanë fushat që buçasin	43
Si ka qenë kjo Myzeqeja	44
Fushat tona sa pjellorre	45
Shqipëri balli me arë	46
Vasil Sota djal' i ri	47
Tetëqind ballë uniteti	48
Uniteti ynë do të jetë çelik	49
Hysni Kapo komisari	50

II

Tunde ti, moj Çeta Plakë	51
Mallakastra nuk dorëzohet	53
Flamuri me yll përpjetë	54
Korriku më datën tetë	55
Te ujët e ftohtë në Poçem	56
Bëri Balli një «Kongres»	57
Unë të njoh ty historinë	59
Përbëti Koshovicë u ndez luftë e rreptë	60
Barutin me grusht e hanë	61
Dhjetë sokolat e malit	62
Do marr penën për të shkruar	64
Lule Feride, moj xhan	65
Djalë trim i Myzeqesë	67
Bishti i malit, o i shkretë	68

Mu në mes të Lushnjës	69
Val' e trubullt vjen Shkumbini	70
Dervish Hekalit	71

III

Këngë pér Skënderbeun	73
Këngë pér Bajram Currin	74
Myzeqarët luftojnë	76
Në Greshicë vajte e re	77
Isuf beu në Karbunarë	78
Pritm', o Isuf beu, pritm',	79
Dërgon pasha një ferman	80
Hajde, more trimi Lika	81
Topi bam e ti po tutje	82
Mos më dil përpara kalit	83
Moj Greshica maj-a-maja	84
Del, o Lumi i Vlorës	85
Dolën gratë si thëllëza	86
Sokëllin Rrapo Hekali	87
Doli marsi e hyri prilli	88
Unë jam nga Shqipëria, Abdyl Frashëri	89
Del Ismaili nga deti	90
Shqipërinë ç'e nderoi	91
Lanet pac, moj ditë e martë	92
Qaf' e Vlorës maj-a-maja	93
Nëntëqind e njëzet viti	94
Këngë pér Naun Dokon (Prifti)	95
Këngë pér kryengritjen e Fierit	96
Me cil ma zure mazaranë	97
Të mërkurën në sabah	98
Haxhi Demçja po bajrak	99
Kënga e kaçakut	100
Trime ishte myzeqeja	101

IV

Kur të rritesht bëhu trim	103
Si Skënderi syshqiponjë	104

Këngë djepi	105
Ninullë	107
Djali nanës, marshalla	108
Atje poshtë me një fushë	109
Dy sorkadhe	110
Hiqe vallen	111
Në bahçenë tënde, moj	112
Zërin ta dëgjova	113
Sevdaja, shokë, sevdaja	114
Ylli i bukur	115
Na ka mbirë një lule	116
Leri lajkat, gocë	118
Ku e gjete dashurinë	119
Dy vajza në çezmë	120
Kur më shkonje rrugës	121
Doli një lule nga pylli	122
Bëhem yll e të ndjek pas	123
M'u dogj xhani, m'këput	124
Na fol me gojë	125
Sylarme, ç'ta kam sevdanë	126
Dielli mbuloi fushën	127
Fryr veriu nga deti	128
C'mbjell ashtu	129
Trëndafil i malit	130
Lule bufka menekshe	131
Në këndim të gjelave	132
Trëndelinë dil te porta	133
Them ta marr	134
Qepja e nishanit	135
Kënga e lajmësit	136
Nuse gusha farfuri	137
Sa gjëzim që ka këtu	138
Ke marr djalin myzeqar	138
Në rrëzë të malit shkova	140
Trëndafili i kuq në lëmë	141
Do vish ti, moj vajzë e vogël	142
Mirë se erdhe, moj nuse	144
Lirikë dasme	145
Do vish me ne	146
O çoban, unë ty të doja	147

Nusja që vjen këtu	148
Po vjen bija në të parë	150
Moj syzeza vetullgozhdë	151
Hipa lart mbi çardhak	152
Do vijnë të të marrin-o	153
Djali le t'mundonet-o	154
Pse më mbahesh kaq me sqimë	155
Qesh e vogël e u rrita	156
Erdhi nusja në oborr	157
Hëna me rreze në dorë	158
Hape vallen mos e mbyll	159
As më le të hyj në bahçë	160
I thonë shokët u trashëgofsh!	161
Mirë se erdhe burbuqe-hëna	162
Me se zihet brumët	163
Lule midis të tjerave	164
Moj mollë e kuqe, të mbajtsha në xhep	165
Moj e vogëla në lis	166
Jo, moj, jo, se bëj shaka	167
Hajde një natë tek unë	168
O kjo anë e lumit	169
Më ngordhi gomari	170
Tundu shkundu, kumbull-o	171
Këta krushq bujarë	172
Këngë humoristike për nusen e dhëndrin	173
S'e dinja se kishit dasmë	174
Rrush i bardhë i dendur	175

KËNGË PËR JETËN E MJERUAR TË SË KALUARËS

Korba, nënë, ku më dhe	176
Pleqtë na tregojnë derte	177
Hyzmeqar derë më derë	178
Beu s'më bëri pjesë	179
U sëmure, s't'u gjend ilaçi	180
Tire-shtire lirin-o	181
Bluaj, o mokër-o	182
Të rriti nëna pa bukë ty	183
Jam një bujk me aganë	184
Nuk e kam nga pleqëria	185

KËNGË TË MOÇME NIZAMI E KURBETI

C'u shkëput një shkëmb nga mali	187
M'u pretë, o këmbë, m'u pretë	188
<i>Kur do ti vemë të shkretit</i>	189
O moj kokë, moj qene	190
<i>Jam nisur në kurbet</i>	191
Më erdhë djali nga kurbeti	192
Porsa dola te guri i bardhë	193
Kopshti im mbeti lëndinë	194
Mine, të paska zënë llota	195
Deri te porta dola e të përcolla	196
Më vjen burri nga kurbeti	197
M'u qepe, rrobë e mavrisë	198
Mjerë sytë e mi ç'kanë parë	199

Zemrat me diell mbushur. Këngë populllore nga rrëthi i Fierit.

(U përg. për bot. nga F. Jorgaqi, M. Margiloj Red. A. Fico); T., «Naim Frashëri», 1981.

208 f.

(B.m.): dhe

(B.v.): 398.8(496.5-3)

Z 45

Tirazhi 1500 kopje Formati 79x100/32 Stash: 2204-59

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1981